

8.1. Programi: PRODHIMI BIMORË – Niveli Bachelor (Bsc)

8.1.1. Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit	Prodhimi Bimorë
KKK Niveli (me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktorate, kurs universitar, certifikatë apo diplomë profesionale)	Bsc (Bachelor)
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Bsc. Prodhim Bimorë, Drejtimi i Shkencat Bimore
Profili i programit akademik	Prodhimi bimorë
Kohëzgjatja minimale e studimit	3 vite
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	E rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	120 ECTS
Modulet /Lëndët (titujt)	<p>Semestri I Matematikë, Kimi dhe Biokimi, Botanikë, Agrometerologjia dhe Fizika Bazike, Shkencat e tokës, Informatika në Bujqësi</p> <p>Semestri II Ekonomia multifunksionale në bujqësi, Pjelloria e tokës dhe plehërimi, Mikrobiologjia, statistika, Inxhinieria bujqësore.</p> <p>Semestri III Gjenetika e bimëve, Fiziologji e bimëve, Hyrje në shkencën bimore I, Bazat e pemëtarisë, Bazat e vreshtarisë</p> <p>Semestri IV Hyrje në Përmirësimin Gjenetik të Bimëve, Bazat e akarologjisë dhe nematologjisë, Bazat e Ampelografisë, Hyrje në Shkencën Bimore II, Lëndë zgjedhore nga Lavërtaria (Bioteknologjia e bimëve).</p> <p>Semestri V Hyrje në mbrojtje të bimëve I, Pemëtaria speciale, Ekosistemet natyrale dhe antropogjenike, Hyrje në bimët foragjere dhe menaxhimi i kullosave, Teknologjia dhe përpunimi i drishtërave, pemëve dhe perimeve.</p> <p>Semestri VI Hyrje në mbrojtje të bimëve II, Prodhimi i perimeve, Mbrojtja Integrale, Lëndë zgjedhore nga pemtari-vreshtari</p>

	(Fisnikrimi i pemëve dhe hardhisë së rrushit dhe Projekti i diplomës.
Numri i vendeve të studimit	200
Udhëheqës i drejtimit të studimit	Prof.Asc.Dr. Bedri Dragusha
Personeli i përhershëm shkencor/artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	11 profesorë të rregullt 6 profesor të asocuar 4 profesor asistentë 8 asistentë
Taksat e studimit	100 €/student/vit

8.1.2. Arsyeshmeria e programit për tregun e punës

Në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, përveç profileve të tjera, ekziston edhe Departamenti për përgatitjen e kadrove nga lëmi i Prodhimit bimor. Shkollimi në këtë Departament është i organizuar në përputhje të plotë me Deklaratën e Bolonjës për nivelin e parë (Bachelor) dhe nivelin e dytë (Master). Studimet në Fakultetin e Bujqësisë kanë filluar në vitin 1974, kur edhe ishte themeluar fakulteti, i cili fillimisht kishte edhe Departamentin e prodhimit bimor, por për shkak të nevojave të atëhershme, ky drejtim ishte shkërrë, ndërsa studimet u organizuan në Drejtimin e përgjithshëm. Nga viti akademik 1988/89 fakulteti u profilizua në disa drejtime. Hartimi i këtij programi për Prodhim bimor mund të përcaktohet si prioritet dhe interes i veçantë për njohuri dhe shkencë në interes të ekonomisë së vendit. Kosova aktualisht importon një numër të konsideruar të prodhimeve duke filluar nga lënda e parë, prodhimeve bujqësorë të gatshme por edhe ushqime (60-80%). Si rezultat i shtimit të vazhdueshme të popullsisë, shtohen edhe kërkesat për prodhime bujqësore. Prandaj, ekziston nevoja e vazhdueshme kërkesat dhe sfidat e këtilla mund të përballohen vetëm me edukim dhe përgatitje të gjeneratës duke fituar kompetenca profesionale e shkencore bashkëkohore, për të aplikuar të arriturat dhe risit nga lëmi i prodhimit bimor, të kontribuojë në shtimin e rendimenteve për njësi të prodhimit dhe sigurim të mjaftueshëm të ushqimit për vendin. Programi i tillë gjithëherë ka me prioritet kujdesinë e veçantë të organizimit të prodhimit bimorë por edhe mbrojtjes së mjedisit, pasi që prodhimi bimor jo profesional është edhe kontribuues në ndotje të mjedisit. Shpejtësia e ndryshimeve tekniko- teknologjike në shoqëritë moderne, nevojat për dije dhe shkencë si dhe transfer të njohurive të reja, zhvillim dhe avancim të lëmit të bujqësisë dhe veçanërisht të prodhimit bimor, por edhe të sektorëve tjerë, imponohet kërkesa që me prioritet të hartohet plani dhe programi i studimeve të reformuara për të dy nivele. Fakulteti ka bazën e domosdoshme për hartim dhe realizimin e planit mësimor, sepse përparësia e kryesore e këtij plan programit të hartuar dhe i propozuar për akreditim, mbështet në trendët e zhvillimit tekniko-teknologjike bashkëkohorë, rekomandimet dhe vendimin e Agjencionit për akreditim të Kosovës (AAK) dhe vlerësimin e programit paraprak ekzistues, nga ana ekspertëve ndërkombëtarë. Hartimi i plan programit të këtillë, baza kryesore mbështetëse ka programin model nga Universiteti i Lubjanës- Slloveni si universitet i parë dhe Universitetit i Hohenheim – Gjermani, si universitet i dytë.

Punësimi i supozuar/mundshëm i studentëve pas përfundimit të studimeve

Në Kosovë nuk ekziston sistem i zhvilluar i grumbullimit të shënimeve për punësimin e të diplomuarve, por në bazë të një pasqyre të përgjithshme shumica e të diplomuarve në Departamentin e Prodhimit bimorë ushtrojnë profesionin e tyre nga lëmi për të cilin kanë

përfunduar studimet. Studentë të cilët përfundojnë studimet në këtë drejtimi do të fitojnë diplomë për nivelin Bsc dhe munde të punësohen dhe vetë punësohen në:

- Ministri e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Shkolla të mesme profesionale,
- Kuvende komunale,
- Inspektorate komunale dhe republikane,
- Dogana,
- Pemishte dhe Vreshta,
- Ndërmarrje të prodhimit dhe përpunimit të lëndës së parë

Një numër i konsiderueshëm i të diplomuarve janë punësuar në ndërmarrje private:

- Serra për prodhim komercial (prodhim i perimeve dhe bimëve dekorative), por edhe në organizata të ndryshme joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.
- Vetëpunësohen me krijim të ndërmarrje të vogla dhe të mesme nga lëmi i prodhimit bimorë,(prodhim dhe përpunim të farës, fidanëve, luleve).

Studentët e rinj në këtë departament mund të regjistrohen pas përfundimit të shkollimit të mesëm profesional bujqësorë, drejtimit natyror-teknik, por edhe pas përfundimit të shkollimit në gjimnaze. Nxënësit mund të aplikojnë për regjistrim, pasi të kenë kryer me sukses provimin e maturës dhe të diplomojnë.

8.1.3. Orientimi i programit të studimit sipas parimeve udhëheqëse të institucionit

Programi i studimit, për programin e prodhimit bimorë është në përputhje të plotë me parimet udhëheqëse të institucionit. Programi është hartuar në bazë të sistemit të Bolonjës

8.1.4. Qëllimi dhe profili i programit të studimeve (përshkrimi i programit)

Qëllimi kryesor i studimeve akademike është që studentët të njohin lëmin e gjerë të shkencës së prodhimit bimor, vlerësim dhe zhvillim të rolit dhe rëndësisë së bimëve bujqësorë dhe prodhimit bujqësorë në përgjithësi. Ky program i dedikohet edukimit profesional që të kuptojnë natyrën ndër disiplinore të bazuara në metoda bashkëkohore.

Studenti duhet të njihet dhe zotërojë me parimet themelore të prodhimit bimor përmes diskutimeve duke përfshirë bimët arave, lëmin e pemëtarisë, vreshtarisë , perimtarisë, përmirësimit gjenetik të bimëve,gjenetikën e bimëve dhe krijimin e kultivarëve dhe hibrideve të reja për nevojat e bujqësisë kosovare, Bioteknologji të bimëve, teknologjia e prodhimeve dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore.

Qëllimi tjetër me rëndësi në edukim akademik është formimi dhe përgatitja profesionale e të interesuarve që kanë edukim nga shkencat natyrore dhe inxhinierie, me qëllim të ndërlidhjes së shkencave natyrore (Biologji, Kimi, Fizikë dhe Matematikë, Makineri, Informatikë) me teknologjinë përpunuese dhe prodhuese në nivelin më të lartë shkencorë dhe aplikativ.Pjesa teorike në ligjërata dhe laborator, do të kompletohet me punë praktike në terren duke eksperimentuar me fusha eksperimentale, grumbullim i të dhënave përmes hulumtimeve praktike dhe teorike si dhe interpretim dhe aplikim të tyre.

8.1.5. Rezultatet e pritura të mësimit (kompetencat dhe kualifikimet, njohuritë dhe shkathësitë)

Deri në fund të kursit, studentët duhet të:

- Thellojnë njohuritë e fituara nga shkollimi paraprak në shkencat bazike (matematikë,

- statistikë, biologji, fizikë, etj.).
- Kuptojnë dhe zotërojnë ndërtimin dhe funksionimin, sistematikën dhe biologjinë e bimëve,
 - Njohë terminologjinë e prodhimit bimor si dhe me parimet bazë të organizimit dhe prodhimit bimor,
 - Të kuptojnë dhe zotërojnë me parimet themelore të menaxhimit të tokës bujqësore, përmirësimit dhe shtimit të rendimentit në sasi dhe cilësi,
 - Zbatojnë standardet për vlerësim të farës në laborator dhe fushë,
 - Përdor metodat dhe protokollet laboratorike në proceset bioteknologjike, gjenetike, biokimike, fiziologjike dhe agroteknike.
 - Vlerësojnë arritjen e standardeve dhe kritereve të shërbimit profesional e shkencor sipas protokollove laboratorik,
 - Respektojnë e afatet e punimit, mbjelljes, kultivimit, mbrojtjes, vjeljes, ruajtjes dhe deponimit, përpunimit të llojeve të ndryshme të prodhimeve bimor, sasi dhe cilësi të lartë,
 - Propozojë veprime konkrete për korrigjime dhe përmirësime në hallkat e zinxhirit të gjatë të prodhimit nga lënda e parë e deri në produktin gjysmë final dhe final,
 - Përshtatshmëri ndaj kushteve të punës në terren (fushë) dhe laborator, autonomi, mundësi e avancimit profesional në karriere profesionale e shkencore.

8.1.6. Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit 50% me 50% në lëndët profesionale.

8.1.7. Plani i hulumtimeve

Për programin Prodhimi Bimorë, plani i hulumtimit do të orientohet në disa drejtime.

Në radhë të parë, përfshirja e studentëve në hulumtime të problemeve praktike në terren dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese duke dhënë propozimet konkrete për përmirësimin e gjendjes në prodhimtarinë primare bimor. Shkëmbimi i përvojave me qendra tjera të raonit dhe më gjerë me qëllim të shkëmbimit të përvojave të ndërsjella.

Përmes memorandumeve të bashkëpunimit është paraparë bashkëpunimi me ekonominë në aspektin e analizimit dhe hulumtimit të problemeve me të cilat ballafaqohet prodhimtaria bimor dhe bujqësia në përgjithësi dhe si dhe në ofrimin e propozimeve për përmirësimin e gjendjes.

8.1.8. Kushtet e regjistrimit dhe pranimit të studentëve

Përzgjedhja e studentëve të rinj bëhet sipas kritereve të caktuara me Konkurs nga Universiteti i Prishtinës, ku studentët për regjistrim në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në nivelin Bsc duhet të kenë të kaluar Testin e Maturës.

Të drejtë konkurimi për të filluar studimet në programin e Prodhimit Bimorë kanë të gjithë nxënësit të cilët kanë përfunduar maturën shtetërore.

Shtojca e diplomës (Diploma Supplement)

UP- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë implementon shtojcën e diplomës

8.1.9. Pasqyrë e programit

Programi: Prodhimi Bimorë – Niveli Bachelor (Bsc)

Viti 1 – Semestri I

Programi i propozuar i studimit					
	<i>Emërtimi i lëndës</i>	<i>Fondi i orëve</i>	<i>ECTS</i>	<i>Oblig/zgj edhore</i>	<i>Arsimtari i lëndës</i>
1	Matematikë	3+2	5	O	Prof.Dr. Fevzi Berisha
2	Kimi dhe Biokimi	4+2	7	O	Prof.Dr. Sabit Dermaku
3	Botanikë	3+2	5	O	Prof.Dr. Fadil Millaku
4	Agrometeorologjia dhe Fizika Bazike	3+2	5	O	Prof.Dr. Sylë Tahirsyla
5	Shkencat e tokës	2+2	4		Prof.Dr. Xhevdet Elezi
6	Informatika në Bujqësi	2+2	4	O	Prof.Asc.Bashkim Baxhaku
	<i>Gjithsejt kredi</i>		30		

Viti 1 – Semestri II

Programi i propozuar i studimit					
	<i>Emërtimi i lëndës</i>	<i>Fondi i orëve</i>	<i>ECTS</i>	<i>Oblig/zgj edhore</i>	<i>Arsimtari i lëndës</i>
1	Ekonomia multifunkionale në bujqësi	3+2	6	O	Prof. Ass. Mustafë Pllana
2	Mikrobiologjia	3+2	6	O	Prof.Ass. Driton Sylejmani
3	Pjelloria e tokës dhe plehërimi	3+2	6	O	Prof.Dr. Xhevdet Elezi
4	Statistika	3+2	6	O	Prof.Dr.Mujë Gjonbalaj
5	Inxhinieria Bujqësore	3+2	6	O	Prof. Asc.Mentor Thaqi
	<i>Gjithsejt kredi</i>		30		

Viti 2 – Semestri III

Programi i propozuar i studimit					
	<i>Emërtimi i lëndës</i>	<i>Fondi i orëve</i>	<i>ECTS</i>	<i>Oblig/zgj edhore</i>	<i>Arsimtari i lëndës</i>
1	Gjenetika e bimëve	3+2	7	O	Prof.Dr. Shukri Fetahu
2	Fiziologji e bimëve	3+2	6	O	Dr.sc. Bekim Gashi

3	Hyrje në shkencën bimore I	3+2	7	O	Prof.Asc.Sali Aliu
4	Bazat e Pemëtarisë	2+2	3	O	Prof.Dr. Sylë Sylanaj
5	Bazat e Vreshtarisë	3+2	7	O	Prof.Asc.Bedri Dragusha
	<i>Gjithsejt kredi</i>		30		

Viti 2 – Semestri IV

Programi i propozuar i studimit					
	Emërtimi i lëndës	Fondi i orëve	ECTS	Oblig/zgj edhore	Arsimtari i lëndës
1	Hyrje në Përmirësimin Gjenetik të Bimëve	3+2	7	O	Prof.Asc. Sali Aliu
2	Bazat e Akarologjisë dhe Nematologjisë	3+2	5	O	Prof.Ass. Fadil Musa
3	Bazat e Ampelografisë	3+2	6	O	Prof.Asc.Bedri Dragusha
4	Hyrje në Shkencën Bimore II	3+2	6	O	Prof.Asc.Imer Rusinovci
5	Lëndë zgjedhore nga Lavërtaria (Bioteknologjia e bimëve)	3+2	6	Z	Prof.Dr. Shukri Fetahu
	<i>Gjithsejt kredi</i>		30		

Viti 3 – Semestri 5

Programi i propozuar i studimit					
	Emërtimi i lëndës	Fondi i orëve	ECTS	Oblig/zgj edhore	Arsimtari i lëndës
1	Hyrje në Mbrojtje të bimëve I	4+2	7	O	Prof. Dr. Adem Demaj Prof. Ass. Dr. Fadil Musa
2	Pemëtari speciale	3+2	6	O	Prof.Dr. Sylë Sylanaj
3	Ekosistemet Natyrale dhe Antropogjenike	3+2	6	O	Prof.Ass. Arben Mehmeti
4	Hyrje në Bimët Foragjere dhe Menaxhimi i Kullosave	3+2	5	O	Prof.Asc.Imer Rusinovci
5	Teknologjia dhe Përpunimi i Drishtërave, Pemëve dhe Perimeve	3+2	6	O	Prof.Asc.Salih Salihu
	<i>Gjithsejt kredi</i>		30		

Viti 3 – Semestri 6

Programi i propozuar i studimit					
	Emërtimi i lëndës	Fondi i orëve	ECTS	Oblig/zgj edhore	Arsimtari i lëndës
1	Hyrje në Mbrojtje të Bimëve II	4+2	6	O	Prof. Ass.Dr. Fadil Musa Prof.Ass.Dr.Arben

					Mehmeti
2	Prodhimi i Perimeve	3+2	6	O	Prof.Dr. Skender Kaçiu
3	Mbrojtja Integrale	3+2	6	O	Prof. Ass. Dr. Fadil Musa
4	Lëndë zgjedhore nga Pemtari-Vreshtari (Fisnikrimi i pemëve dhe hardhisë së rrushit)	3+2	6	O	Prof.Dr. Sylë Syllanaj
5	Punimi i Diplomës	50	6	O	
	Gjithsejt kredi		30		

8.1.10. Përshkrimi i modulit/ lëndës

MATEMATIKA

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Matematika
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	I (parë)
Numri i orëve në javë:	5
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	e enjte nga ora 8³⁰ - 14⁰⁰ - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Fevzi Berisha
Detajet kontaktuese:	tel. 044-126-989, e-mail: exiberisha@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Lënda ka të bëjë me njohuri nga matematika që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në problemet nga bujqësia
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi me njohuritë nga matematike të nevojshme për aplikimin në shkencën e Bujqësisë dhe veterinarisë
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studentit do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi aparatit matematikor. Studentët duhet të jenë në gjendje: - të zbatojnë bashkësitë numerike në shqyrtimet dhe prezantimin e kuptimeve tjera si nga algebra ashtu edhe nga analiza matematike - të njoh kuptimin e matricës dhe përcaktorëve si

	<p>dhe të vërtetoi vetit e përcaktorëve të cilat zbatohen për zgjidhjen e sistemit të ekuacioneve</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zgjidh sistemet e ekuacioneve në forma dhe mënyra të ndryshme - të zbatoi vetit e vargut aritmetik dhe gjeometrik në zgjidhjen e problemeve të ndryshme - të paraqes grafikisht funksionet themelore elementare - të zbatoi limitin e funksionit për të përcaktuar vazhdueshmërinë e funksionit - të nxjerr derivatin e funksioneve elementare dhe në bazë të vetive të derivatit të gjejë derivatin e secilit funksion, - duke u bazuar në derivatin e funksionit të shqyrtoi dhe të paraqes grafikisht funksionet - duke u bazuar në derivatin e funksionit të shqyrtoi dhe të paraqes grafikisht funksionet - të gjejë integralin e pacaktuar për disa klasa të funksioneve - të zbatoi integralin e caktuar në zgjidhjen e disa problemeve nga gjeometria dhe mekanika
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	3	9
Përgaditja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	6	1	5
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			100

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë 20%</p> <p>Vlerësimi i dytë 20%</p> <p>Angazhimi në ushtrime 10%</p> <p>Vijimi i rregullt 5%</p>

	Provimi final	45%
	Total	100%
Literatura		
Literatura bazë:	1. Fevzi Berisha-Abdullah Zejnullahu: Matematika-për arkitekturë , 1996, Prishtinë. 2. Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2, Prishtinë 2006.	
Literatura shitesë:	1. Ejup Hamiti – Matematika I, II. Elektro Prishtinë 2. Isak Hoxha – Matematika I,I Ndërtimtari, Prishtinë 3. Ismet Dehiri – Matematika I,I Fakultet Teknik, Prishtinë 4. Përmbledhje të ndryshme të detyrave 5. W.Feller –An introduction to probability theory and its application,1970,New York 6. Interneti.	
Plani i dizajnuar i mësim:		
Java	Ligjerata që do të zhvillohet	
Java e parë:	Numrat realë	
Java e dytë:	Induksioni matematik, formula e binomit	
Java e tretë:	Numrat kompleksë	
Java e katërt:	Fuqizimi dhe rrënjëzimi i numrave kompleksë	
Java e pestë:	Matricat, veprimet me matrica	
Java e gjashtë:	Përcaktorët- matrica inverse	
Java e shtatë:	Sistemet e ekuacioneve lineare	
Java e tetë:	Metodat për zgjidhjen e sistemit të ekuacioneve	
Java e nëntë:	Vargjet numerike	
Java e dhjetë:	Limiti dhe vazhdueshmëria e funksioneve	
Java e njëmbëdhjetë:	Derivati i funksionit	
Java e dymbëdhjetë:	Zbatimi i derivatit të derivatit të funksionit në shqyrtimin e funksioneve dhe problemeve nga bujqësia	
Java e trembëdhjetë:	Integrali i pacaktuar	
Java e katërbëdhjetë:	Integrali i caktuar	
Java e pesëmbëdhjetë:	Zbatimi i integralit të caktuar në gjeometri dhe mekanikë	
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:		
Mbajtja e qetësisë në mësim Ndalja e telefonave celularë Hyrja në sallë me kohë Respektimi i rregulloreve për student		

KIMI DHE BIOKIMI

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”- Fakulteti i Bujqësisë& Veterinaris]		
Titulli i lëndës:	Kimia dhe Biokimia		
Niveli:	BSC		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	1 (parë)		
Numri i orëve në javë:	4+2		
Vlera në kredi – ECTS:			
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr.sc. Sabit Dërmaku		
Detajet kontaktuese:	Sabit.dermaku@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Kimia dhe Biokimia janë lëndë natyrore eksperimentale		
Qëllimet e lëndës:	Duhet të korrespondojnë me objektivat e Fakulteti përkatës		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Listoni 3-5 rezultate të të nxënit		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	4	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	30	60
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	0	0	0
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	0	0	0
Përgaditja përfundimtare për provim	0	0	0
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	0	0	0
Projektet, prezentimet, etj	0	0	0
Totali			184
Metodologjia e mësimdhënies:	Përshkruani se çfarë metodologjie do të përdoret gjatë ligjërimit të lëndës?		
Metodat e vlerësimit:	Është e rëndësishme që studentëve tu ipen		

	informata rreth mënyrës së vlerësimit,(në colloquium dhe provim final).
Literatura	
Literatura bazë:	Sabit Dërmaku, Biokimia, Prishtinë 2007.
Literatura shtesë:	Mujë Rugova&Tahir Gjegjbitriqi, Kimia,1998.
Plani i dizajnuar i mësimimit: 6 javë Kimi dhe 9 javë Biokimi	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Struktura e materjes. Struktura e atomit. Struktura e molekulave.
Java e dytë:	Formulat kimike. Lidhjet kimike.
Java e tretë:	Reaksionet kimike; nxehtësia, ekuilibri kimik, kinetika e reaksioneve kimike, katalizatorët, reaksionet redoks.
Java e katërt:	Forcat ndër molekulare: gjendjet e materjes, diagramet e fazës, lidhjet hidrogjenore.
Java e pestë:	Tretjet: koncentrimet, tretshmëria. Acidet dhe bazat. Acidet dhe bazat e dobta. Acidet dhe bazat e forta.
Java e gjashtë:	Molekulat e vogla organike: struktura, vetitë, aplikimi, grupet funksionale, izomerët, reaktiviteti.
Java e shtatë:	Karbohidratet: Struktura, vetitë, reaktiviteti dhe funksionet në organizëm.
Java e tetë:	Lipidet: Struktura, vetitë, reaktiviteti dhe funksionet në organizëm. Membranat biologjike.
Java e nëntë:	Proteinat- Aminoacidet: Struktura, vetitë dhe funksionet në organizëm
Java e dhjetë:	Enzimet: struktura kimike, katalizat funksioni dhe rregullimi i aktivitetit.
Java e njëmbëdhjetë:	Nukleotidet dhe Acidet nukleike: struktura dhe funksioni.
Java e dymbëdhjetë:	Faza e parë e katabolizmit. Tretja dhe hyrja e makromolekulave në metabolizëm.
Java e trembëdhjetë:	Faza e dytë e katabolizmit: zbërthimi i glukozës(glikoliza), B-oksidimi i acideve yndyrore dhe zbërthimi i aminoacideve (cikli i uresë) deri në Acetil-CoA.
Java e katërbëdhjetë:	Faza e tretë e katabolizmit: cikli i krebsit .
Java e pesëmbëdhjetë:	Anabolizmi: Biosinteza e karbohidrateve, acideve yndyrore dhe steroideve. Integrimi dhe rregullimi i metabolizmit.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Pjesëmarrja e rregullt në ligjerata dhe ushtrime.</p> <p>Rregullat e mirësjelljes, si psh: mbajtja e qetësisë dhe ndëgjimi gjatë ligjeratave.</p> <p>Prezenca me kohë në sallë apo laborator gjatë mësimimit.</p> <p>Shkyqja e telefonave mobil gjatë mësimimit.</p>	

BOTANIKË

Të dhënat bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Botanikë
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (viti i parë)
Numri i orëve për javë:	3+2
Vlera e kredive – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	/
Mësimdhënësi:	Prof.dr.sc. Fadil Millaku
Detajet kontaktuese:	fadil.millaku@hotmail.com / +377 44 394 000
Përshkrimi i kursit:	<p>Njohja e studenteve me rëndësinë që ka bota bimore në përgjithësi e në veçanti bimët ushqyese, mjekuese dhe helmuese të cilat janë përdorë në të kaluarën por edhe sot kanë rëndësi të madhe në industrinë e ushqimit, farmaceutikës dhe më gjerë. Njohja me ndërtimin e qelizës bimore, indeve, organeve bimore dhe me sistematikën dhe ekologjinë e bimëve. Përfitimi i njohurive të studenteve lidhur me rëndësinë e bimëve për njeriun dhe aspektet ekologjike, taksonomike dhe gjeobotanike me qëllim të njohjes me të mirë, shfrytëzimit racional, kultivimit dhe mbrojtjes së tyre.</p>
Rezultatet e të mësuarit:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studentet do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Përshkruajnë dhe të njohin anën anatomiko-morfologjike të bimëve2. Kuptojnë ndërtimin e qelizës dhe organeve qelizore3. Kuptojnë ndërtimin e indeve dhe organeve vegjetative4. Kuptojnë morfologjinë e organeve vegjetative si dhe metamorfozat5. Kuptojnë morfologjinë dhe rëndësinë e organeve riprodiktive- lules, lulesave, frutave, farës.6. Mësojnë bazat e taksonomisë së bimëve si dhe grupet e rëndësishme taksonomike të bimëve si: Bimët e ulëta (algat, kërpudhat dhe likenet), Myshqet (Bryophyta), Fiernat (Pteridophyta), Farëzhveshurat (Pynophyta) dhe bimët Farëveshura (Angjiospermae).

	<ol style="list-style-type: none"> 7. Dallojnë bimët Dikotile (Magnoliophyta) dhe Monokotile (Liliopsida). 8. Njohin speciet bimore të rëndësishme në aspektin evolutiv, ekonomik dhe mjekësor. 9. Bëjnë prerje të organeve vegjetative dhe reprodutive të bimëve dhe ato t'i analizojnë përmes mikroskopit. 10. Determinojnë grupet bimore dhe speciet e caktuara. 11. Marrin, herbarizojnë apo mbledhin pjesë nga bimët dhe ato t'i përdorin. 12. Orientohen në natyrë me qëllim të gjetjes së llojeve bimore të caktuara. 13. Përdorin literaturë adekuate për determinimin e bimëve 14. Përmes çelësit për determinim të përcaktojnë speciet e caktuara. 15. Të kyçën në rrjetën botërore të informatave lidhur me botën bimore. 16. Shfrytëzojnë biblioteka, internet dhe burime tjera për mësim të vetëdrejtuar. 17. Punojnë në mënyrë efektive në grupe ose të pavarur në orët praktike në laborator ose jashtë tij në natyrë.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të mësuarit)

Aktiviteti	Orët	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike / laboratorike	1	15 javë	15
Punë praktike	1	15 javë	15
Kontakte me mësimdhënësin	1	5 javë	5
Ushtrime terreni	16	3 ditë	16
Prezantime, Seminare	2	2 javë	4
Detyrë shtëpie	1	6 javë	6
Koha individuale e shpenzuar duke mësuar (në bibliotekë/shtëpi)	1	15 javë	15
Përgaditja përfundimtare për provim	3	10 javë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, test përfundimtar)	6	1 javë	6
Projekte, prezantime, etj.	1	1 ditë	1
Gjithsej	23	64	158

Metodat e mësimdhënies	Ligjërata, diskutime, komentime, punë individuale dhe në grupe.
-------------------------------	---

Metodat e vlerësimit	Vlerësimi i parë (citologji, histologji dhe ndërtim i organeve vegetative) 30% Vlerësimi i dytë (morfologji, sistematikë, Bimë mjekësore) 30% Detyrat e shtëpisë dhe angazhime tjera 10 % Vijimi i rregullt 5% Provimi final 25%
Literatura	
Literatura bazë:	Millaku. F. Praktikum i botanikës , KGT, Prishtinë (2005)
Literatura shtesë:	Millaku, F. Bimët mjekësore, Broshurë 2011 Rexhepi, F. Botanika I dhe II, Prishtinë, (2001) Topuzi, L. Botanika e përgjithshme, Tiranë (1997) Sherifi. E. Anatomia dhe morfologjia e bimëve, Prishtinë (2001) Hundozi. B. Anatomia e bimëve, ETMM, Prishtinë, (1987) Krasniqi, F. Sistematika e bimëve të larta me elemente të filogjenesisë, ETMM Prishtinë, (1985) Wilhem, N.: Allgemine Botanik, 11. Aufl. Thieme, Shtuttgart, (2001) Mborja, S. Botanika I, II shblu, Tiranë (1970) Magdefrau, K. Ehrendorfer, F. Botanika, Zagreb, (1978) Burime interneti, p.sh.: Wikipedia.org
Dizajnimi i planit studiuës:	
Javë	Ligjëratat që do të mbahen
Java e parë:	Botanika e përgjithshme, emërtimi, përmbajtja, ndarja dhe zhvillimi historik
Java e dytë:	Qeliza, ndërtimi, forma, madhësia dhe Organelet qelizore
Java e tretë:	Citoplazma - Fotosinteza
Java e katërt:	Paraplasti (pareti qelizor, vakuola dhe lëngu qelizor) dhe ndarja qelizore
Java e pestë:	Indet bimore (histologjia)
Java e gjashtë:	Ndërtimi i organeve vegetative
Java e shtatë:	Morfologjia e organeve bimore
Java e tetë:	Riprodhimi i bimëve
Java e nëntë:	Organet reprodutive të bimëve të larta : Lulja, simetria, diagrami i lules
Java e dhjetë:	Frutat dhe fara: ndërtimi dhe llojet e frutave
Java e njëmbëdhjetë:	Bazat e taksonomisë së bimëve, Bimët e ulëta (algat, kërpudhat dhe likenet)
Java e dymbëdhjetë:	Klasifikimi i bimëve të larta
Java e trembëdhjetë:	Bimët farëveshura (Angiospermae)
Java e katërbëdhjetë:	Bimët Monokotile, karakteristikat morfologjike dhe

	klasifikimi i tyre.
Java e pesëmbëdhjetë:	Bimët mjekësore në Republikën e Kosovës, grumbullimi dhe mundësit e kultivimit
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studentet duhet të jenë të rregullt në mësim, duhet të jenë aktiv gjatë ligjëratave, duhet të përgatiten dhe të bëjnë pyetje gjatë seancave mësimore, duhet të mbajnë disiplinë, t'i shkyçin telefonat celular, të vinë me kohë në ligjëratat dhe mos të pengojnë mbarëvajtjen e mësimin.	

AGROMETEROLOGJIA DHE FIZIKA BAZIKE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Agrometeorologjia dhe Fizika Bazike
Niveli:	BSC
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I pare
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Prishtine
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Syle Tahirsylaj
Detajet kontaktuese:	stahirsylaj@yahoo.com syle.tahirsylaj@uni-pr.edu mob +377 44 140 761
Përshkrimi i lëndës	Objektiv primar i këtyre dy lëndëve mësimore është që: studentët të marrin njohurit e duhura nga disiplinat e fizikës me qëllim të aplikimit të tyre në agrometeorologji, studentet të arrinë shkallë të lartë të njohurive për aplikimin e ligjeve të fizikës dhe Agrometeorologjisë në lëndet e tjera si motra në lëmin e inxhinjerisë bujqësore. Observimin dhe saktësimi i elementeve dhe dukurive meteorologjike, agrometeorologjike dhe klimatologjike për prognozatat agrometeorologjike me qëllim të ruajtjes së kulturave bujqësore nga efektet negative që vijnë si rezultat i kushteve të motit në shkallë vendi dhe rajon. Përdorimi dhe mirëmbajtja e instrumenteve meteorologjike si dhe gjeoinstrumentët.
Qëllimet e lëndës:	Objektiv primar i këtyre dy lëndëve mësimore është që studentët të marrin njohurit e duhura nga disiplinat e fizikës me qëllim të aplikimit të tyre në agrometeorologji Studentet do të njihën me metodat e observimit

	<p>dhe saktësimin të elementeve dhe dukurive meteorologjike në shkallë vendi dhe me gjërë sipas termineve të OBM për nëvojat e agrometeorologjisë , prognozave agrometeorologjike,si dhe metodat fenologjike-fenometrike.</p> <p>Studentet do të marrin njohuri të mira për proceset atmosferike të cilat ndodhin për shkak të ndyshimit të elementeve dhe dukurive meteorologjike në tokë dhe atmosferë.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Të njohin në shkallë të lartë ligjet dhe ligjeshmerit e disciplionave të fizikës me qëllim të aplikimit të njejtave në fizikën e atmosferës dhe agrometeorologji. 2.Të njohin mirë metodat e observimit dhe saktësimin të elementeve dhe dukurive meteorologjike si, dhe me matjet klimatologjike dhe ato agrometeorologjike. 3.Të njohin mirë metodat e mbrojtjes së pemeve dhe kulturave bujqësore nga ngricat pranverore dhe të marrin masat e duhura preventive për mbrojtjen e të njejtave nga ato ngrica. 4.Të njohin mire aparatoren dhe instrumentet matëse meteorologjike dhe matjet agrometeorologjike. 5.Të njohin mirë shfrytëzimin e energjisë së përsëritshme për nëvojat e bujqësisë. 6.Njohuritë e fituara nga këto lëndë ti shfrytëzojnë për lidheshmerinë e këtyre lëmive në degët e tjera të bujqësisë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	3	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2	30
Punë praktike	3	8	24
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	8	1	8
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në	2	6	12

shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjerat, ushrtime, pune praktikene grupe, seminare, konsultime, casje interactive, prezentime te studenteve etj.		
Metodat e vlerësimit:	Përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier e percaktonë vlerësimin definitiv. Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë; 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Skender.Skenderi ,Rashit Maliqi :Fizika për studentet e fakulteteve teknike 2004 Mandili,T, Tili ,I.Meteorologjia Bujqesore per fakultetin Agronomise pjesa e I dhe e II 1980 Tiranë Tahirsylaj,S:(Fizika me Agrometeorologji dispencë, 2006) Zorba,P(Klimatogjeografia- Tiranë, 2006) Tahirsylaj,S: (Praktikum i meteorologjisë, 2005) Tahirsylaj, S:(Ushtrime numerike në meteorologji dhe agrometeorologji dispencë ,2005) Mandili, T(Klima dhe kulturat bujqësore,1975 Tiranë) Milosavlevic,M(Meteorologjia,1980 Prishtinë përthim në gjuhën shqipe)		
Literatura shtesë:	1. ASHAT(Klima e Shqiperisë,1978 Tiranë) WMO(OBM) Atlasi i reve pjesa e I, II në CD		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Mekanika		
Java e dytë:	Mekanika e trupit të ngurtë		
Java e tretë:	Dinamika		
Java e katërt:	Dinamika e lëvizjës translative		
Java e pestë:	Puna dhe energjia. ligji i njutnit i gravitetit.		
Java e gjashtë:	Dukuritë termike. fizika molekulare.		
Java e shtatë:	Meteorologjia si shkencë dhe ndarja e saj. ndarja vertikale e atmosferës.		

Java e tetë:	Nocionet e përgjithshme mbi atmosferën. Rrezatimi idielit, atmosferës dhe tokës.
Java e nëntë:	Nxëmja e tokës dhe atmosferës
Java e dhjetë:	Shtypja e ajrit
Java e njëmbëdhjetë:	Avulli i ujit në atmosferë
Java e dymbëdhjetë:	Mjegullat dhe retë
Java e trembëdhjetë:	Reshjet
Java e katërbëdhjetë:	Rrymimet ajrore
Java e pesëmbëdhjetë:	Çrregullimet atmosferike. dukuritë optike dhe elektrike në atmosferë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes konform statusit të universitetit.

SHKENCAT E TOKËS

Course description	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë&Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Shkenca e tokës
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	obliguar
Viti i studimeve:	I-rë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi-ECTS:	4
Koha /semestri:	I-rë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.dr. Xhevdet Elezi
Detajet kontaktuese:	xhevdet.elezi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Hyrje në gjeologji-agrogeologji, historiku I zhvillimit të shkencës. Njohuri bazë për tokëformimin dhe kronologjia gjeologjike. Mineralogjia dhe Petrografia. Biologjia e tokës dhe karakteristikat e lëndës organike në tokë. Fizika e tokës (mineralet e argjilit, tekstura, stuktura, dendësia, poroziteti, vetitë fiziko-mekanike. Relacioni tokë-ujë. Evolucionit dhe morfologjia e tokës. Pedogjeneza, faktorët dhe proceset pedogjenetike.
Qëllimet e lëndës:	Të ofroj studentëve njohuri bazë për tokëformimin. Njohuri për faktorët dhe proceset agrogeologjike dhe pedologjike me qëllim të avancimit pozitiv të tyre. Të ofroj njohuri për studentët përkitazi me mundësinë e përvetësimit të metodologjive bashkëkohore dhe praktikave të mira në

	menaxhimin e tokës në prodhimtarinë bimore.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>-Aftësimi i studentëve për të përshkruar faktorët dhe proceset e tokëformimit.</p> <p>-Njohuri të mjaftueshme për të dalluar vetitë e materialit të krijimit të tokës dhe horizonteve tokësore.</p> <p>-Studentet do të aftësohen që të përgatisin projekte duke përshkruar karakteristikat/vetitë agrogeologjike, pedologjike, por edhe vetitë biologjike të saj.</p> <p>-Njohuri të mjaftueshme me metodat analitike për përcaktim të vetive fizike, dhe biologjike (lënda organike), si dhe interpretimi i rezultateve në korrelacion me kërkesat në prodhimtarinë bimore.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	3	1	3
Ushtrime në terren	5	1	5
Seminare	5	1	5
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, seminare, provim final)	4	2	8
Projektet, prezentimet, etj.	3	1	3
Totali			120
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime terreni dhe laborator, diskutime dhe seminare.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 20% Vlerësimi i dytë: 20% Detyrat e shtëpisë dhe angazhimet tjera: 10% Vijimi i rregullt: 5% Provimi përfundimtarë (me gojë): 45%		
Literatura			
Literatura bazë:	Dispensa: Shkenca e tokës, 2011.		
Literatura shtesë:	1. Handbook of Soil science, Malcolm E. Sumner, 2000.		

	<p>2. Fundamentals of soil science, 8 E, Henry D. Foth, 1990.</p> <p>3. Uji në kontinuitetin tokë-bimë-atmosferë, Besnik Gjongecaj, 1998.</p> <p>4. Soil Sampling, Preparation, and Analysis, Kim H. Tan, 1996.</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në gjeologji-agrogeologji, Lënda e studimit të gjeologjisë-agrogeologjisë dhe ndarja e saj, Historiku i zhvillimit të shkencës së agrogeologjisë, Njohuritë themelore mbi tokën, Forma, madhësia dhe ndërtimi i tokës, Fundi oqeanik dhe lëvizja e kontinenteve, Formimi i tokës, Kronologjia gjeologjike, Toka si sistem trefazorë, Karakteristikat e fazave të veçanta të tokës.
Java e dytë:	Mineralogjia-Mineralet shkëmbore–mineralet petrogjene, Rëndësia e mineraleve, Vetitë fizike të mineraleve, Mineralet primare dhe sekondare.
Java e tretë:	Petrografia-shkëmbinjët, shkëmbinjët magmatik (eruptiv), shkëmbinjët metamorf-ik, shkëmbinjët sedimentarë.
Java e katërt:	Thërrmimi (zbërthimi) i shkëmbinjëve dhe mineraleve, Bartja e prodhimeve të shpërbërjes, Mineralet e argjilit, Vetitë e përgjithshme të mineraleve të argjilit dhe rëndësia ekologjike.
Java e pestë:	Biologjia e tokës, Lënda organike, humusi dhe organizmat në tokë, Definicioni i materies organike dhe humusit të tokës, Pëbërja dhe vetitë e humusit, Ndarja e humusit sipas funksionit dhe tipit, Karakteristikat e humusit, Rëndësia e humusit për tokën, Përmbajtja e humusit në tokë, Flora dhe Fauna e tokës (pedofauna).
Java e gjashtë:	Vlerësimi i parë (test)
Java e shtatë:	Fizika e tokës, Vetitë fizike të fazës së ngurtë të tokës, Klasifikimi i tokës sipas përbërjes mekanike (klasët e teksturës së tokës), Ndikimi i teksturës në vetitë e tokës dhe pjellorinë e saj (rëndësia ekologjike e përbërjes mekanike të tokës), Analiza mekanike e tokës.
Java e tetë:	Struktura e tokës, Faktorët dhe mekanizmat e strukturimit, Stabiliteti i strukturës, Rëndësia ekologjike e strukturës së tokës, Dendësia specifike dhe ngjeshja e tokës, Dendësia specifike vëllimore, Poroziteti.
Java e nëntë:	Vetitë fizike–mekanike të tokës, Konzistenca e tokës, Plasticiteti i tokës, Ngjitshmëria e tokës, Bymimi dhe kontraksioni.
Java e dhjetë:	Uji në tokë (uji i tokës), Format e ujit në tokë, Forca (energja) e lidhjes së ujit për tokë, Tensioni i thithjes së ujit,

	Konstantat hidrologjike (ujore), Qarkullimi i ujit në tokë, Rexhimi dhe bilanci ujour i tokës, Uji dhe toka–karakteristikat dhe sjellja.
Java e njëmbëdhjetë:	Vetitë e nxehtësisë së tokës, Faktorët e jashtëm të nxehtësisë së tokës, Vetitë e brendshme të nxehtësisë së tokës, Vetitë tjera të nxehtësisë së tokës, Rexhimi i nxehtësisë së tokës, Ajri në tokë (përbërja dhe vetitë), Qarkullimi i ajrit në tokë (ajrosja, ventilimi), Kapaciteti i tokës për ajër.
Java e dymbëdhjetë:	Krijimi i tokës-Pedogjeneza, Faktorët pedogjenetikë (substrati amë, klima, relievi, bota e gjallë, njeriu, koha).
Java e trembëdhjetë:	Proceset pedogjenetike (thërrmimi i shkëmbinjëve amë, krijimi i mineraleve të argjilit-argjilogjeneza, transformimi i materies organike, procesi i shpërlarjes së kriprave, procesi i kripëzimit, procesi i kafezimit, procesi i erozionit, lesivimi, podzolizimi, proceset aluviale, pseudoglejzimi, glejzimi, antropogjenizimi.
Java e katërbëdhjetë:	Evolucioni i tokës, Morfologjia e tokës, ngjyra.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë (test)
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijimi me rregull, interesimi gjatë ligjëratave, kujdesi ndaj pajisjeve.	

INFORMATIKA NË BUJQËSI

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës Programi : Prodhim bimor
Titulli i lëndës:	Informatika ne bujqësi
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligatorë
Viti i studimeve:	1
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	E enjte 8:30 – 10 Fakulteti i B & V
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Bashkim Baxhaku
Detajet kontaktuese:	Tel: 044-145-765 emali: bashkim.baxhaku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Studenti aftësohet për përdorimin e kompjuterit personal. Ai aftësohet për shkrimin e raporteve me editorët e tekstit (MS Word – Microsoft Office), si dhe krijimin e tabelave, llogaritjet tabelore dhe prezantimin e rezultateve ne formë te grafikeve.
Qëllimet e lëndës:	Te aftësoj studentet në njohjen me lëmine e informatikës. Te aftësohet te njehe pjesët e kompjuterit personal. Te

	aftësohet për aplikimin e programeve Windows – programit operativ të kompjuterit personal. Te aftësohet për punë me tekst procesorët për shkrimin e një raporti, teksti. Te aftësohet për krijimin e tabelave të ndryshme në Excel dhe në Word, si dhe të aplikojë llogaritjet tabelore dhe prezantimin e rezultateve tabelore me metodat grafike.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Te përdor kompjuterin personal për punët e veta. 2. Shkrimi i raporteve të ndryshëm ku përfshihen insertimi i fotografive, i formulave si dhe objekteve tjetër në dokumentin e punuar në Word. 3. Krijimi i tabelave të ndryshme, llogaritjet tabelore me të dhënat e faqeve të librit punues në Excel si dhe prezantimi i rezultateve tabelore në formë të grafikeve të ndryshëm 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	5	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	2	10
Përgatitja përfundimtare për provim	10	2	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	4	2	8
Projektet, prezantimet, etj.	2	2	4
Totali	33	59	137
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata klasike ku studenteve ju prezantohen materia e lëndës; seminarët nga një pjesë e lëndës që studenti e zgjedh për me e përpunuar; pas çdo ligjëratë hapet diskutimi për materien e përpunuar në ligjëratë ku studenti mund të kyçet me konstatimet e veta, sugjerimet ose pyetjet për lëmin që është përpunuar atë orë.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë – 20%		

	<p>Vlerësimi i dytë – 20%</p> <p>Vlerësimi i tretë – 20%</p> <p>Projekti dhe angazhime tjera 10%</p> <p>Vijimi i rregullt – 10%</p> <p>Provimi final – 20%</p> <p>Total 100%</p>
Literatura	
Literatura bazë:	Bashkim Baxhaku – Bazat e informatikës (Pajisjet, Sistemi operativ, Word-i dhe Excel-i)
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. PC Hardware in a Nutshell, 3rd Edition by Robert Bruce Thompson and Barbara Fritchman Thompson (Paperback - Jul 30, 2003) – Illustrated 2. Windows XP Annoyances for Geeks, 2nd Edition by David A. Karp 3. Windows XP in a Nutshell, Second Edition by David A. Karp 4. Word 2007 Bible by David Angell, Peter Kent, and Brent Heslop 5. Excel 2007 Bible by John Walkenbach
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Pajisjet – njësit hyrëse dhe dalëse; pllaka amë; tastiera; Pajisjet – tastiera; miu; njësia qendrore – mikroprocesori; Memoria operative RAM; Memoria vetëm për lexim – ROM; kesh memoria; Njësit dalëse: kartela grafike dhe monitori.
Java e dytë:	Pajisjet – Njësit dalëse: printeri (shtypësi); Njësit hyrëse – dalëse: Disku, CD, DVD, kartela e zërit, kartela e rrjetit, pajisjet për prezantim
Java e tretë:	Softueri, sistemi operativ; Softueri aplikativ; Freeware dhe Shareware Open Source dhe Free Software; Paraqitja në sistem; Desktopi; Dritaret; Menytë; Dialogët; Ndhima; Dalja nga Windows-i; Startimi dhe mbyllja e aplikacioneve.
Java e katërt:	Puna me më shumë aplikacione ose dritare njëkohësisht; Operacionet themelore me fajlla dhe folderë; Krijimi i fajllave dhe folderëve; Zgjedhja e fajllave dhe folderëve Menyja File; Menyja Edit; Menyja View; Menyja Favorites; Menyja Tools.
Java e pestë:	Lëshimi i Word-it në punë; Dritarja kryesore e Word-it; Menyja kryesore; Puna me menytë e Word-it; Pullat kryesore; Pullat për paraqitje ne ekran; Shiritat me vegla.
Java e gjashtë:	Shkrimi i tekstit; Lëvizja nëpër tekst; Ruajtja e tekstit; Emrat e fajllave; Ruajtja e fajlit në folderin aktual; Ruajtja në folder tjetër; Ruajtja e fajlit ekzistues ne disk; Hapja e fajlit.
Java e shtatë:	Hapja e fajlit ekzistues; Dalja nga Word-i; Gjetja dhe

	korrigjimi i tekstit; Zgjedhja e tekstit; Kopjimi, zhvendosja dhe fshirja e tekstit; Tipi dhe madhësia e shkronjave; Zgjedhja e njëkohshme e parametrave të tekstit.
Java e tetë:	Hapja e Excel-it; Pamja e ekranit në Excel; Mënyra të tjera të hapjes së Excel-it; Shkrimi në hapësirën punuese; Dritarja kryesore e Excel-it; Menyja kryesore; Pullat kryesore; Pullat që lidhen me dokumentin e hapur.
Java e nëntë:	Shiritat me vegla; Shiriti standard; Shiriti për formatizim; Shirita të tjerë; Zhvendosja e shiritave; Ruajtja e librit punues; Emrat e fajlave; Ruajtja e fajlit në folderin aktual; Ruajtja e fajlit në folderin tjetër; Ruajtja e fajlit ekzistues në disk; Ruajtja e librit punues përmes tastierës.
Java e dhjetë:	Mbyllja e librit punues; Mbyllja e Excel-it; Hapja e librit punues; Hapja e librit punues të ri; Hapja e librit punues ekzistues; Selektimi i qelive; Pamja e të dhënave; Rregullimi i madhësisë së qelive; Rregullimi manual; Rregullimi automatik; Rregullimi përmes opsionit Format; Lartësia e rreshtave; Gjerësia e kolonave.
Java e njëmbëdhjetë:	Lëvizja në fletën punuese; Lëvizja përmes tastierës; Lëvizja përmes miut; Pozicionimi në qelinë e caktuar; Rregullimi i të dhënave në qeli; Rrafshimi, centrimi dhe dhëmbëzimi; Lloji dhe madhësia e shkronjave; Fonti; Madhësia e shkronjave; Stili i fontit; Zgjedhja e njëkohshme e parametrave të fontit; Përcaktimi i parametrave për më shumë qeli.
Java e dymbëdhjetë:	Shkrimi me ngjyra të ndryshme; Shkrimi vertikal; Shkrimi i teksteve të gjata; Editimi i të dhënave; Gjetja dhe zëvendësimi; Kopjimi; Zhvendosja; Fshirja e të dhënave.
Java e trembëdhjetë:	Insertimi i qelive, i rreshtave dhe i kolonave; Insertimi i rreshtave; Insertimi i kolonave; Fshirja e qelive, e rreshtave dhe e kolonave; Fshirja e qelive; Fshirja e rreshtave; Fshirja e kolonave; Bashkimi i qelive.
Java e katërbëdhjetë:	Diagramet; Aktivizimi i sistemit grafik; Hapat që ndiqen gjatë vizatimit; Rregullimi i diagramit; Tipa të tjerë të diagrameve.
Java e pesëmbëdhjetë:	Paraqitja e disa kolonave njëkohësisht; Vendosja e rrjetit; Pozicionimi i legjendës; Shënimi i vlerave brenda diagramit; Vendosja e tabelës me vlera; Paraqitja tredimensionale.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studenti është i obligueshëm për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrime (mbahet evidenca), duhet të mbaje qetësinë gjatë mësimit, hyrja para arsimtarit – pas arsimtarit nuk lejohet hyrja në sallën e mësimit.	

Semestri II

EKONOMIA MULTIFUKSIONALE NË BUJQËSI

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqesise dhe Veterines
Titulli i lëndës:	Ekonomia multifunkcionale
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i pare
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri II/ Prishtine
Mësimdhënësi i lëndës:	Mustafe Pllana
Detajet kontaktuese:	mustafe_p@yahoo.com 044/185-692
Përshkrimi i lëndës	
Përshkrimi i lëndës	Përshkruani lëndën.
Qëllimet e lëndës:	<p>Pas perfundimit te keti kursi (moduli) studenti do te jet ne gjendje qe :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Te kuptoi pse eshte me rendesi te studiohet ekonomia, cka jane doktrinat ekonomike apo mesimet ekonomike dhe cilat jane ato doktrina,cka studion mikroekonomia e cka makroekonomia, - Te dij se cilat jane problemet ekonomike per cdo shoqeri njerezore, cka eshte ekonomia e tregut,ekonomia e komanduar dhe ajo e perzier;faktoret e prodhimit,pasuria dhe mireqenia, - Te dij se cka eshte tregu tregu,kerkesa (faktoret te cilet ndikojne ne kerkese),oferta(faktoret te cilet ndikojne ne oferte),ekuilibri/disekuilibri,elasticiteti i kerkeses dhe ofertes,dobia - Te mesoi per firmat,prodhimin,koston;konkurrencen,(konkurrenca e plote,monopoli,oligopoli); - Te mesoi per sektorin publik;politikat makroekonomike;instrumentet e politikës makroekonomike;ciklet ekonomike;shtimi ekonomik;madhesite globale makroekonomike(GNP,GDP,NNP,Konsumi,Investimet);papunesia dhe inflacioni;paraja dhe sistemi bankar;politika monetare;politika fiskale.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Te dalloj se cka eshte ekonomia e lire e tregut,ekonomia e komanduar dhe ajo e perzier; me cilat probleme ballafaqohet ekonomia 2. Percaktoj faktoret qe ndikojne ne kerkese dhe oferte te tregut dhe te joekuilibrit te tregut 3. Te dalloj firmat nga aspekti i pronesise ne ato private,ortakeri dhe korporata si dhe llojet e kostove te tyre ,letrat me vlere te tyre dhe bilancet 4. Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën ekonomike në vend dhe problemet e rritjes ekonomike duke përdorur treguesit

	makroekonomik të shpjeguar gjatë këtij kursi, 5. Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale dhe monetare në agregatët kryesorë makroekonomik në kontekst të situatave të caktuara, 6. Të vlerësojnë efektet e lidhjeve ndërkombëtare në ekonominë e vendit.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërat	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	3	4	12
Detyra të shtëpisë	4	10	40
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			20
Përgaditja përfundimtare për provim	4	4	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	5	10
Projektet, prezentimet, etj	2	5	10
Totali			180
Metodologjia e mësimdhënies:	Grupe të vogla do të ngarkohen me probleme të caktuara e të cilat studentet do të përgadisnin dhe prezentojnë. Konsultime shtese do të organizohen për të përforcuar materien. Gjatë përkatitjes së punimeve seminarike studentët duhet që të cekin referencat e tyre dhe të jenë në gjendje se teksti i prezentuar nuk është kopje e ndonjë teksti që është prezentuar më parë. Për kësaj prej studentëve kërkohet që punimet seminarike të dorëzojnë edhe në mënyrë elektronike.		
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë mesemestral 20% Testi i dytë mesemestral 20% Testi final 40% Punimi seminarik,detyrat 10% Angazhimi 10%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Grup autoresh :Hyrje ne Ekonomi,PEGI,Tirane ,2002 2. Dr.Musa Limani :Hyrje ne Ekonomi,Prishtine,2002		

	3. Dr.Mustafe Pllana.Ushtrime te Mikro dhe Makroekonomise, Libri Shkollor, Prishtine, 2012
Literatura shtesë:	S.Dobson,S.Palfreman:Introductionto Economics,Oxford,University Press.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Çka studion ekonomia. Ne cilat dege ndahet ekonomia.Cka studion mikroekonomia. Cka studion makroekonomia. Doktrinat ekonomike (merkantilizmi, fiziokratizmi, ekonomia politike klasike, teoria ekonomike neoklasike)
Java e dytë:	Cilat jane problemet ekonomike per cdo shoqeri njerezore.Ekonomia e tregut.Ekonomia e komanduar. Ekonomia e perzier.Faktoret e prodhimit,pasuria,mireqenia.
Java e tretë:	Tregu.Kerkesa(faktoret e kerkeses).Oferta(faktoret e ofertes).
Java e katërt:	Ekulibri/Disekuilibri(faktoret te cilet ndikojne ne disekuiliber).Elasticiteti i kerkeses dhe ofertes.Dobia.
Java e pestë:	Firmat.Prodhimi.Kostoja.
Java e gjashtë:	Konkurrenca.Konkurrenca e plote.Monopoli.Konkurrenca jo e plote.
Java e shtatë:	Roli i shtetit ne ekonomi.Financimi i sektorit publik.
Java e tetë:	Qellimet e politikës makroekonomike.Instrumentet e politikës makroekonomike.Ciklet ekonomike.Shtimi ekonomik.
Java e nëntë:	Madhesite globale makroekonomike (GNP, GDP, NNP, Konsumi, Investimet)
Java e dhjetë:	Papunesia (efektet ekonomike, llojet e papunesise). Inflacioni(kuptimi,llojet,pasojat).
Java e njëmbëdhjetë:	Paraja (kuptimi, funksionet) dhe sistemi Bankar
Java e dymbëdhjetë:	Politika monetare (Banka Qenderore, instrumentet e politikës moneare, tregu monetar)
Java e trembëdhjetë:	Politika fiskale (kuptimi, buxheti dhe politika fiskale, borxhi shteteror dhe zhvillimi ekonomik)
Java e katërbëdhjetë:	Mardhenjet ekonomike nderkombetare
Java e pesëmbëdhjetë:	Tregtia e jashtme,faktoret te cilet e kushtezojne tregtine e jashtme,bilanci i pagesave,tregu devizor
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> – Studentët janë të obliguar të iu përmbahen të gjitha politikave dhe rregullave të mirësjelljes sipas Statutit të Fakultetit dhe UP-se – Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje, dhe të marrin pjesë në çdo aktivitet mësimor – Gjatë orëve mësimore nuk lejohet prishja e rendit dhe qetësisë si dhe përdorimi i mjeteve për komunikim. – Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye. 	

PJELLORIA E TOKËS DHE PLEHËRIMI

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë&Veterinarisë		
Titulli i lëndës:	Pjelloria dhe plehërimi i tokës		
Niveli:	Bsc		
Statusi lëndës:	obligative		
Viti i studimeve:	I-rë		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Bujqësisë&Veterinarisë, sipas orarit të shpallur		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.dr. Xhevdet Elezi		
Detajet kontaktuese:	xhevdet.elezi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Format dhe funksionet e lëndës ushqyese në relacionin tokë-bimë. Koncepti modern, zhvillimi historik dhe praktikat për pjellorinë e tokës dhe të ushqyerit e bimëve.		
Qëllimet e lëndës:			
	Aftësimi i studentëve për të kuptuar relacionin në mes të vetive të tokës dhe të ushqyerit të bimës. Studentët duhet të njihen me vetitë e tokës dhe të aftësohen për interpretimin e tyre me qëllim që të jenë të gatshëm të përcaktojnë kohën dhe sasisë e plehrave duke shfrytëzuar metodat më të avancuara.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	<ul style="list-style-type: none"> - Studenti do të aftësohet për të njohur relacionin në mes të vetive të tokës dhe të ushqyerit të bimëve. - Përmes njohurive në ligjërata dhe ushtrime, studentin do të jetë i gatshëm të përshkruan dhe interpretojë vetitë e tokës që do të shtjellohen në kuadër të këtij moduli. - Studentët do të aftësohen të projektojnë, respektivisht hartojnë plane adekuate përkitazi me përshkrimet e vetive të tokës në relacion me të ushqyerit e bimëve. Do të aftësohen me teknikat e analizës së tokës, si dhe komentimin e vetive të tokës duke përcaktuar normat/dozat e plehrave, kohën dhe mënyrën optimale të përdorimit të tyre. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5	1	5

Ushtrime në terren	5	1	5
Seminare	5	1	5
Detyra të shtëpisë	3	3	9
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, seminare, provim final)	7	2	14
Projektet, prezentimet, etj.	7	1	7
Totali			180
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, ushtrime terreni e laboratorit, diskutime dhe seminare.		
Metodat e vlerësimit:			
	Vlerësimi i parë: 20% Vlerësimi i dytë: 20% Detyrat e shtëpisë dhe angazhimet tjera: 10% Vijimi i rregullt: 5% Provimi përfundimtarë (me gojë): 45%		
Literatura			
Literatura bazë:			
	Dispensa: Pjelloria dhe plehërimi I tokës, 2012.		
Literatura shtesë:			
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bergmann W. Nutritional Disorders of Plants, Fisher Jena-New York, 1992. 741 str., ISBN: 3-334-60422-5. 2. Mengel K., E.A. Kirkby. Principles of plant nutrition, 5th Edition. 2001. Kluwer Academic Publishers, 849 str., ISBN: 1-4020-0008-1. 3. Marchner Horst. Mineral Nutrition of higher plants. Academic Publishers, 1995. 4. Charles A. Black. Soil fertility evaluation and control. CRC Press., 1992. 		
Plani i dizajnuar i mësim:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Hyrje. Terminologjia. Përkufizimet. Format dhe funksionet e lëndës ushqyese në relacionin tokë-bimë. Koncepti modern, zhvillimi historik dhe praktikatat për pjellorinë e tokës dhe të ushqyerit e bimëve.		
Java e dytë:	Kimia e tokës: Koloidet e tokës, anionet, kationet. Vetitë adsorbuese të tokës.		
Java e tretë:	Tretja e tokës, kapaciteti i bufereve, kripërat, aciditeti (reaksioni), potenciali oksido-reduktues.		
Java e katërt:	Cikli bio-gjeo-kimik i elementeve në sistemin tokë-bimë, Makroelementet.		

Java e pestë:	Cikli bio-gjeo-kimik i elementeve në sistemin tokë-bimë, Mikroelementet.
Java e gjashtë:	Vlerësimi i parë (test)
Java e shtatë:	Teoritë e absorbimit
Java e tetë:	Klasifikimi i tokës, njësitë themelore të klasifikimit, sistemet e klasifikimit.
Java e nëntë:	Tokat automorfe.
Java e dhjetë:	Tokat hidromorfe
Java e njëmbëdhjetë:	Vetitë e tokës në relacion me të ushqyerit e bimëve.
Java e dymbëdhjetë:	Metodat bashkëkohore për përcaktimin e praktikës së pjellorisë (koha, doza).
Java e trembëdhjetë:	Sistemi i kontrollit të pjellorisë së tokës, Modele kompjuterike të planifikimit të pjellorisë. Plehërimi dhe mjedisi. Plehërimi në bujqësinë alternative (ekologjike apo organike, bio-dinamike). Rendimenti në sasi dhe cilësi.
Java e katërbëdhjetë:	Plehrat dhe plehërimi. Korniza legjislativë, plehra, tokë, ujë (BE, dhe vende tjera të botës).
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë (test)
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijimi me rregull, interesimi gjatë ligjëratave, kujdesi ndaj pajisjeve.	

MIKROBIOLOGJIA

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Buqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Mikrobiologji
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Buqësisë dhe Veterinarisë,
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Driton Sylejmani, Prof.ass Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Buqësisë dhe Veterinarisë Departamenti i Veterinarisë
Detajet kontaktuese:	Fakulteti i Buqësisë dhe Veterinarisë driton.sylejmani@uni-pr.edu

Përshkrimi i lëndës	Në këtë kurs studentët do të mësojnë për mikrobiologjinë. Format e mikroorganizmave dhe ndarjen e tyre. Klasifikimin e mikroorganizmave dhe rolin e tyre në prodhimin e bimor. Ekologjinë e mikroorganizmave, fiziologjinë e tyre, metabolizmin dhe frymemarrjen e mikroorganizmave. Fermentimin si proces mikrobiologjik. Rritjen dhe shumezimin e mikroorganizmave. Metanogjenezen dhe metanogjenet. Rolin e mikroorganizmave në qarkullimin e karbonit dhe të azotit. Mikroorganizmat në biogjeosferë. Mikroflora e bimeve dhe rëndësia e saj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që studentët e këtij niveli të studimeve të mund të marrin njohuri dhe aftësi të përgjithshme dhe speciale për mikroorganizma. Ky kurs ka për qëllim ofrimin e të gjitha njohurive që kanë të bëjnë me proceset kryesore të mikroorganizmave (fiziologjinë, metabolizmin, shumezimin, të ushqyerit dhe frymemarrjen e mikroorganizmave) si dhe me disa procese ku marrin pjesë si në qarkullimin e karbonit, azotit etj. Studentet do të njihen edhe me mikroflorën e bimeve dhe rëndësinë e kësaj mikroflorë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kene njohurite e duhura për mikrobiologjinë dhe mikroorganizmat • Dijne të klasifikojnë mikroorganizmat • Aplikojnë njohuritë e fituara duke identifikuar sidomos bakteret Gram+ dhe Gram- në laborator, • Identifikojnë mikroorganizmat që marrin pjesë në fermentim si proces mikrobiologjik • Identifikojnë mikroorganizmat që marrin pjesë në fiksimin e azotit • Njohin mikroflorën e bimeve dhe rëndësinë e saj.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1x15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1x15	15
Punë praktike	4	1x5	20
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	3	1x15	45
Ushtrime në teren	6	1x2	12
Kollokfiime,seminare	4	1x2	8

Detyra të shtëpisë	1	1x6	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në	2	1x15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1x3	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim	2	1x2	4
Projektet, prezentimet, etj	2	1x2	4
Totali	29		180
Metodologjia e mësimdhënies:	Mund të ndryshojë dhe bazohet në punën individuale dhe bashkëpunimi në grup. Metodatat e mësimdhënies që do të përdoren janë ligjërat, puna në grupe, seminare, prezantime, demonstrime, vizita studimore. Ligjërata (40%) Puna praktike (20%) Punë individuale dhe prezantim nga studentet (20%) Udhëzues tjerë (10%) Vlerësimi (10%)		
Metodat e vlerësimit:	Alternativa të shumëfishta, E saktë/E pasaktë, dhe Ese pyetje. Vlerësimi i parë: 25%, Vlerësimi i dytë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Kapituj të zgjedhur nga burimet e mëposhtme. • M.Gillings &A.Holmes: Plant Microbiology (2004) • Varma,Ajit, Abbott, Lynette, Werner, Dietrich: Plant Surface Microbiology (2007)		
Literatura shtesë:	Materialet e ligjëratave dhe ushtrimeve (Skriptat) të përgatitura nga arsimtari i lëndës të cilat do tu dorëzohen studentëve në fund të çdo ligjërata (ose këto skripta do të vendosen në faqen e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë). Shumë faqe të internetit dhe video janë të dobishme.		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Hyrje. Mikrobiologjia si lëndë.		
Java e dytë:	Morfologjia dhe ndërtimi i mikroorganizmave.		
Java e tretë:	Ekologjia e mikroorganizmave.		
Java e katërt:	Metabolizmi i mikroorganizmave.		
Java e pestë:	Frymëmarrja e mikroorganizmave.		
Java e gjashtë:	Fermentimi dhe roli i mikroorganizmave në këtë proces.		

Java e shtatë:	Fotosinteza
Java e tetë:	Rritja dhe shumëzimi i mikroorganizmave.
Java e nëntë:	Metanogjeneza dhe metanogjenet.
Java e dhjetë:	Roli i mikroorganizmave në qarkullimin e karbonit në natyrë.
Java e njëmbëdhjetë:	Roli i mikroorganizmave në qarkullimin e azotit në natyrë
Java e dymbëdhjetë:	Mikroorganizmat në pedosferë.
Java e trembëdhjetë:	Mikroorganizmat në biosferë.
Java e katërbëdhjetë:	Mikroflora e bimëve dhe roli i saj.
Java e pesëmbëdhjetë:	Mikroflora e rizosferës, epifite, parazite.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Suksesi i studentit në këtë kurs do të varet nga zhvillimi i vetdisiplinës.
- Rregullat e mëposhtme do të ndihmojnë në sigurimin e përvojës së të mësuarit për secilin.
- Arsimtari i lëndës do të fillojë mësimin vetëm nëse klasa është e pastër dhe e rregulluar dhe nëse në klasë do të jenë materialet e nevojshme për fillimin e mësimit.
- Studentëve nuk u lejohet që të hanë ushqim ose pije në klasë gjatë orës së mësimit.
- Të gjitha pajisjet elektronike dhe telefonat celularë duhen të fiken gjatë orës së mësimit (përveç nëse kërkohen nga mësuesi).
- Studentët duhet të ndjekin udhëzimet e mësuesit gjatë gjithë kohës së mësimit dhe të mos flasin pa u dhënë leje.
- Studentët janë të obliguar që menjëherë dhe rregullisht të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat dhe ushtrimet dhe që nga dita e parë e fillimit të mësimit do të bëhet mbajtja e evidencës mbi vijimin e mësimit.
- Nëse studenti ka dy mungesa të paarsyeshme gjatë semestrit atij do ti dërgohet vërejtje me e-mail dhe do të caktohet një takim me të, për mungesa të paarsyeshme më të shumta (studenti që ka tre mungesa pa arsye nuk do të siguron nënshkrimin nga mësuesi i lëndës) do të merret administrata ose menaxhmenti i fakultetit.
- Do të mbahet dokumentacion i shkruar për çdo mashtrim apo pandershmi gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit.

STATISTIKA

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Prodhimtaria Bimore
Titulli i lëndës:	Statistika
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Pare
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	

Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.dr.Muje Gjonbalaj		
Detajat kontaktuese:	Muje.gjonbalaj@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Lënda e Statistikes perqendrohet ne njohjen e studenteve me konceptet themelore të statistikes (popullaten, mostren, variablat, parametrat...), modalitetet e shperndarjes se dukurive, dizejnimin e eksperimetit, verifikimin e hipotezave, interpretimin e rezultateve statistikore..., Per me shume studentet do te perfshihen ne ushtrime praktike në dy nga softweret statistikore: SPSS dhe MINITAB.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lendes Bazat e Statistikes është që ti aftesoj studentët te kuptojne rolin dhe rëndësinë e statistikës së përgjithshme dhe në veçanti të asaj bujqesore, lidhur me principet themelore, metodat dhe modelet statistikore dhe mënyrën e aplikimit të tyre në analizat bujqesore.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lende studentët do të jenë në gjendje që të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpjegojnë nocionet themelore statistikore 2. Kuptojnë llojet e grupimit statistikore 3. Dizejnojne eksperimentin, 4. Verifikojnw hipotezat 5. Llogarisin dhe interpretojne treguesit mesatare, të variacionit, indekset 6. Përcaktojnë dhe interpretojnë rezultatet e korelacionit. 		
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	-	-	-
Punë praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	3	6
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	6	18
Projektet, prezentimet, etj	2	11	22

Totali		175
Totali I ECTS		7
Metodologjia e mësimdhënies:	1. Ligjerim 2. Ushtrime 3. Teste të vlerësimit (2) 4. Punë seminarike 5. Debate grupore	
Metodat e vlerësimit:	Studentet duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë e fituara gjatë kursit. Vlerësimi i studentëve si me poshte. Vlerësimi i parë: 20% Vlerësimi i dytë: 20% Detyrat e shtëpisë dhe angazhime tjera 20% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 35% Total 100%	
Literatura bazë:	1. Troni, H. Statistika aplikative ne bujqësi. 2001, Prishtinë.	
Literatura shtesë:	1. Robert D. Mason, Douglas A. Lind, Eëlliam G. Marchal, Statistical techniques in business and economics, tenth edition. The Irëin/Me Grow - Hill Series 1996. 2. Nuhiu, R. dhe Shala, A. Bazat e Statistikës. 1995, Prishtinë	
Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java		
Java e parë:	Konceptet themelore statistikore	
Java e dytë:	Organizimi i shërbimit dhe fazat e studimit statistikorë	
Java e tretë:	Statistika ne periudhen e kompjuterit Eksperimenti statistikore	
Java e katërt:	Shpërndarja e frekuencave Analiza e formave dhe e koncentrimit të serive statitkore Distribuimet simetrike, distribuimet asimetrike	
Java e pestë:	Analiza e mostrave dhe karakteristikat e tyre	
Java e gjashtë:	Madhesite mestare	
Java e shtatë:	Kuptimi dhe rendesia e treguesve te variacionit	
Java e tetë:	Vleresimi i pare	
Java e nëntë:	Analiza dinamike	
Java e dhjetë:	Interpretimi i rezultateve të variaces përmes softwareve statistikore	
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza e regresionit	
Java e dymbëdhjetë:	Interpretimi i rezultateve të regresionit përmes softwareve statistikore	

Java e trembëdhjetë:	Analiza e korrelacionit-Koeficientit Determinacionit dhe i Aleancës
Java e katërbëdhjetë:	Interpretimi i rezultateve të korelacionit përmes softwareve statistikore
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi idyte

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime

- Rregullat e mirësjelljes 'si:
- Përciellja me kujdes të ligjëratave
- Ardhja në klasë me kohë
- Ckyqja e Telefonit

INXHINIERIA BUJQËSORE

Të dhëna bazike të lëndës

Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Inxhinieria bujqësore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2-të
Numri i orëve në javë:	75
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Mentor Thaqi. Prof. Asoc. Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë - Departamenti i Prodhimit Bimorë
Detajet kontaktuese:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Zyra Nr. 28
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs tenton të aftësojë studentët për shfrytëzimin racional të mekanizmit bujqësorë me qëllim të rritjes së prodhimitarisë dhe fitimit, zgjedhjen e drejt gjatë furnizimit me mekanizëm të ri e të përshtatshëm që për momentin mungon, njohurit për mekanizmin adekuat për prodhimin bujqësorë, shfrytëzimi i drejt, rregullimi dhe mirëmbajtja e makinave para, gjatë dhe pas punës.
Qëllimet e lëndës:	Lënda Mekanizimi bujqësorë ka për qëllim organizimin sa më të mirë të mësimit dhe për të bërë të mundur përvetësimin nga ana e nxënësve jo vetëm të njohurive teorike por edhe krijimin e shprehive praktike që janë të domosdoshme për aplikimin e mekanizmit optimal në prodhimtarinë bimorë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të: Shpjegojnë llojet e traktorëve sipas konstruktit dhe destinimit;

	<p>Përshkruajnë makinat dhe veglat për meliorim, bonifikim dhe sistemim te tokave</p> <p>Përshkruajnë makinat për punimin e tokës</p> <p>Përshkruajnë makinat për shpërndarjen e plehrave</p> <p>Përshkruajnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e makinave për përgatitjen e sanës;</p> <p>Përshkruajnë dhe dallojnë makinat për përgatitjen e silazhit;</p> <p>Përshkruajnë makinat mbjellëse të perimeve</p> <p>Përshkruajnë përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve</p> <p>Përshkruajnë makinat dhe pajisjet për ujitje</p> <p>Përshkruajnë metodat dhe pajisjet për krasitjen e pemëve dhe hardhisë</p> <p>Përshkruajnë makinat për korrjen e kulturave lavërtare, pemëve dhe primeve</p>
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit

(që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	3.0	15	45.0
Ushtrime (pune praktike, seminare, ushtrime, etj)	2.0	15	30.0
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	2.0	2	4.0
Detyra të shtëpisë	1.0	15	15.0
Projekte, prezantime..etj.	3.0	2	6.0
Koha e studimit vetanak	1.0	15	15.0
Përgatitja përfundimtare për provim	1.0	9	9.0
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kolokvium, provim final)	3.0	2	6.0
Totali	13.0	15	130.0

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata, ushtrime, qasje interaktive, konsultime, punim seminari, punë në grupe, etj.</p> <p>Ligjërata (30%)</p> <p>Puna praktike (pune fushore, pune laboratorike) (30%)</p> <p>Pune individuale dhe prezantim nga studentet (20%)</p> <p>Udhëzues tjerë (10%)</p> <p>Vlerësimi (10%)</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë: 20%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 20%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%</p> <p>Vijimi i rregullt 10%</p>

	Provimi final 40% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	Materialet e ligjëratave dhe ushtrimeve (Teksti mësimorë) të përgatitura nga arsimtari i lëndës (Mentor Thaqi) të cilat do tu dozohen studenteve në fund të çdo ligjërate (ose ky material do të vendoset në faqen e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë).
Literatura shtesë:	Artikuj shkencor të mësimdhënësit të lëndës të cilët mund të gjenden në faqet e revistave shkencore Internet).

Plani i dizajnuar i mëimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë:	Përdorimi i traktorit në prodhimtarinë blegtorale Ndarja e traktorëve sipas kategorive Mekanizmi përcjellës- lidhës Ndërruesi i shpejtësive Diferenciali përcjellës i përparmë dhe i prapmë
Java e dytë:	Përdorimi i traktorit në prodhimtarinë blegtorale Sistemi i drejtimit të traktorit Sistemi i frenimit dhe llojet e tij Instalimet e ndriçimit dhe sinjalizimit Sistemi hidraulik i traktorit Përdorimi i traktorit dhe mirëmbajtja e tij.
Java e tretë:	Makinat dhe veglat për meliorim, bonifikim dhe sistemim të tokave Makinat për hapjen dhe pastrimin e kanaleve Makinat për drenazhim Makinat dhe pajisjet për shkuljen e cungjeve Makinat për pastrimin e tokës nga gurët Makinat për rrafshimin e tokës.
Java e katërt:	Makinat për punimin e tokës Plugjet Përdorimi i tokëthelluesve Frezat Makinat dhe veglat për punimin sipërfaqësor të tokës Makinat e kombinuara në punimin bazë dhe plotësues të tokës Makinat për formimin e vllajave Makinat për mulçirimin e tokës
Java e pestë:	Makinat për shpërndarjen e plehrave Shpërndarësit e plehrave kimik Shpërndarësit e plehurat organik

Java e gjashtë:	Makinat mbjellëse Mbjellësja e bimëve në rreshta të ngushtë Makinat për menaxhimin e livadheve dhe kullosave
Java e shtatë:	Makinat mbjellëse të perimeve Makinat dhe pajisjet për prodhimin e fidanit
Java e tetë:	Makinat për prodhimin e ushqimit voluminoz Makinat kositëse Makinat për tharjen e barit në fushë Rimorkiot ngarkuese Makinat presuese të sanës
Java e nëntë:	Prodhimtaria e silazhit Objektet për silazhim – siloset Kombajna e silazhit
Java e dhjetë:	Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve Makinat spërkatëse të bimëve Atomizerët (vesuesit) Mjegulluesit (teknika aerosol) Makinat dhe aparatet për pluhurosje
Java e njëmbëdhjetë:	Makinat dhe pajisjet për ujitje Ujitja me brazda të gjata Ujitja në formë të pikave Ujitja në formë shiu artificial Sistemet vetëlëvizëse për ujitje Ujitja në mjedise të mbrojtura
Java e dymbëdhjetë:	Krasitja e pemëve dhe hardhisë Pajisjet mekanike, pneumatike dhe elektrike për krasitje
Java e trembëdhjetë:	Makinat për korrjen e kulturave lavërtare Procesi teknologjik i punës së kombajnit Specifikat e korrjes së sojës Korrja e lulediellit me kombajnë
Java e katërbëdhjetë:	Makinat për korrjen e misrit
Java e pesëmbëdhjetë:	Vjelja e perimeve Vjelja e pemëve dhe rrushit
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Pjesëmarrja e studenteve e ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Reflektimi në punë në grupe është i dëshirueshëm.	

Semestri III

GJENETIKË TË BIMËVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I BUJQËSISË-VETERINARISË
Titulli i lëndës:	GJENETIKË TË BIMËVE

Niveli:	BSc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i dytë. Semestri i tretë (III).
Numri i orëve në javë:	3 +2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E hane : 8 :00 – 12:00 // FBV
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Shukri Fetahu
Detajet kontaktuese:	shfetahu@hotmail.com dhe shukri.fetahu@uni-pr.edu Banka Gjenetike e Kosovës-Resurset Bimore

Përshkrimi i lëndës	Përshkruani lëndën.
Qëllimet e lëndës:	Studentët të njohin dhe interpretojnë parimet dhe ligjshmëritë themelore të trashëgimisë dhe të ndryshueshmërisë së organizmave të gjallë - bimëve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Njëhë dhe interpreton ligjshmëritë gjenetike për trashëgimi dhe ndryshueshmëri të organizmave bimore. ➤ Njëhë strukturën gjenetike të kromozomeve, gjeneve përmes ADN dhe ARN-së. ➤ Interpreton rekombinimet dhe trashëgimin e ekspresionit të gjeneve në gjenotip dhe fenotip. ➤ Interpreton format e poliploidisë (euploidisë dhe aneuploidisë). ➤ Parimet e përgjithshme të gjenetikës së populacioneve.

Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin / konsultimet	1	3	3
Ushtrime në teren	2	2	4
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha vetanake e studimit - studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6

Projektet, prezantimet ,etj	1	1	1
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime teorike dhe laboratorike, seminar, prezantim, diskutim, punë në grupe, fusha eksperimentale etj).		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i suksesit të studentëve, realizohet: pjesa me shkrim-pyetësorit dhe pjesa me gojë, përfundimtare.</p> <p>Vlerësimet caktohen nga mësimdhënësi sipas dinamikës së realizimit të syllabusit të lëndës.</p> <p>Vlerësimi me test:</p> <p>Vlerësimi i parë: 30%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 25%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 10%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi final: 30%</p> <p>Total 100%</p> <p>Studenti që ka akumuluar 60% të pikëve në test kalon për tre afate. Pjesa me gojë nota kaluese është 6 deri 10 (gjashtë deri dhjetë).</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Tamarin R.(2003): Principles of Genetics, Fourth Edition. Boston University. WCB. Wm. C. Brown Publishers. Dubuque. Iowa, Melburn, Australia, Oxford, England. 2. Hartl D. L. and E. W. Jones. 2004. Genetics: Analysis of Genes and Genomes. 6th edition, Jones & Bartlett, Sudbury, MA. 854 p. ISBN: 0-763-71511-5. 3. Fetahu Sh. (2009): Gjenetikë, Ligjërata të autorizuara. Pjesa e parë. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë. 4. Salillari A., Hoxha S.(2002): Gjenetika ,Tirane 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 5. Howel S. H. 1998. Molecular Genetics of Plant Development, Cambridge University Press, Cambridge: p. 1-5, 9-24, 30-37. ISBN: 0-521-58255. 6. Russell, P., J.,(1998): Genetics, Fifth Edition. The Benjamin / Cummings Publishing Company, Inc. 2725 Sand Hill Road. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Gjenotipi, mjedisi dhe fenotipi.
Java e dytë:	Mejoza dhe gametogjeneza. Koncepti i rekombinimeve
Java e tretë:	Ekspresion i gjeneve. Trashëgimi autosomal dhe ndryshueshmëria dhe ekspresioni në fenotip.
Java e katërt:	Alelet dhe trashëgimi potencial i tyre. Koodominimi. Trashëgimi Dominant- recesiv. Alelet multiple.
Java e pestë:	Ndërveprimet në mes gjeneve. Veprimi epistatik dhe hipostatik i gjeneve. Poligenet. Efektet e Pleiotropisë.
Java e gjashtë:	Trashëgiminë e veçorive lidhura. Harta gjenetike. Organizimi i ADN-së në kromozome dhe gjenet. ADN-së mitokondriale dhe kloroplasteve
Java e shtatë:	Organizimi i gjenomit te eukariotike. ADN repetitive, qendromerat dhe telomeret. Struktura e gjeneve te eukariotet
Java e tetë:	Ekspresioni i informacionit të trashëguar. Ndryshueshmëria fenotipike dhe ekspresioni i gjeneve, norma e reaksionit. Përcaktimi i seksit dhe trashëgimi i veçorit të lidhura për seks.
Java e nëntë:	Komponent e ndryshueshmërisë gjenetike. Tiparet kuantitative.
Java e dhjetë:	Rregullimi i funksionit gjenit. Strukturën molekulare të ADN-së. Analoget bazë, burime të mutacioneve. Efektet e rrezatimit UV dhe jonizues mbi ADN-së.
Java e njëmbëdhjetë:	Mekanizmat korigjuese. Hibridizimi i acideve nukleike. Mekanizmat molekularë të rekombinimeve. Modeli Epigjenetike.
Java e dymbëdhjetë:	Intronet dhe ekzonet. Ekspresion specifik të gjeneve, ARNi, dhe proteinat. Transkriptimi reversë. Gjenomi i supresuar.
Java e trembëdhjetë:	Kryqëzimet në mes llojeve. Bazat e citogjenetikës. Bazat e gjenomikes. Autopoliploidia dhe aloploidija. Triploidët. Aneuploidia.
Java e katërbëdhjetë:	Aberracionet në kromozome. Mutacionet e induktuara, agjentët dhe kimikatet mutagjen. Mutacionet e gjeneve. Mutacionet e kromozome dhe gjenomit. Linjat e qelizave somatike dhe seleksionimi.
Java e pesëmbëdhjetë:	Gabime të lindura të metabolizmit, bllokada metabolike, bazat e gjenetikes fiziologjike. Trashëgimi dhe sjellja e organizmave. Koncepti i populacioneve në gjenetikë dhe evolucion.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes akademike me studentë.	

FIZIOLOGJI E BIMËVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës Drejtimi: Prodhim bimor
Titulli i lëndës:	Fiziologjia e bimëve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (i dytë)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	E mërkure, ora: 10-15, FSHMN
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. sc. Bekim Gashi
Detajat kontaktuese:	bekim.gashi@uni-pr.edu; cel: +386 49 600 850
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda Fiziologjia e bimëve merret me studimin e dukurive jetësore, gjegjësisht studion proceset që kryhen në organizmin e gjallë bimor, të cilët procese e kontrollojnë rritjen, zhvillimin dhe reagimin e bimëve në një ambient të caktuar jetësor. Njohuritë në fiziologjinë bimore përbëjnë parakushtin e domosdoshëm në zhvillimin e drejtimeve shkencore dhe praktike, si prodhimi dhe përpunimi teknologjik i drithërave të bukës, bimëve industriale dhe mjekësore, bimëve drusore, frutikulturës, vreshtarisë si dhe të gjitha bimëve tjera me interes shkencor dhe ekonomik.</p> <p>Fiziologjia e bimëve luan rol të posaçëm për t'u njoftuar me mekanizmat e proceseve fiziologjike dhe biokimike, njohja e të cilave procese mundëson mënyrën e veprimit në to, duke mundësuar që zhvillimi i organizmave bimor t'i përshtatet nevojave të njeriut, pasi që proceset fiziologjike që kryhen në organizmat bimorë, kanë rëndësi të posaçme për ekzistencën e botës së gjallë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Lënda ka si mision që t'u ofrojë studentëve njohjen e proceseve fiziologjike që kryhen në organizmat bimor dhe njohjen e ligjëshmërive fiziko-kimike që mundësojnë kryerjen e proceseve të ndryshme fiziologjike. Qëllimi mbështetet në njohjen e fiziologjisë së substrukturave qelizore molekulare, qarkullimin e ujit dhe të materieve minerale, posaqërisht metabolizmin e azotit dhe procesin e transpirimit. Rëndësi të posaçme i kushtohet njohjes së preocesit të fotosintezës, frymëmarrjes dhe hormoneve bimore. Gjatë këtij kursi gjithashtu ju</p>

	mund të mësoni edhe për proceset e rritjes dhe zhvillimit të bimëve dhe lëvizjet tropike dhe nastike, fotoperiodizmin dhe fotomorfogjenezën në ndikimin e kushteve të ndryshme të ambientit.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studenti do të jetë në gjendje që: 1. Të kuptojë se si aplikohen konceptet bazë të Fiziologjisë së bimëve në disiplina të tjera të bujqësisë. 2. Të kuptojnë, të dinë dhe të diskutojnë për konceptin e proceseve fiziologjike të bimëve. 3. Të kuptojnë dhe të përshkruajnë distribuimin e proceseve metabolike në qelizë. 4. Të kuptojnë rëndësinë e procesit të ushqimit mineral, transpirimit, fotosintezës dhe të frymëmarrjes te organizmat bimor. 5. Të kuptojnë dhe të shpjegojnë proceset e rritjes dhe zhvillimit të bimëve.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike	5	1 javë	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5 javë	5
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	2	2 javë	4
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15 javë	15
Përgaditja përfundimtare për provim	3	10 javë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	6	1 javë	6
Projektet, prezentimet, etj.	/	/	/
Totali	23	64	140
Metodologjia e mësimdhënies:	Leksione, ushtrime praktike, diskutime, komentime, punë në grupe, etj.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë (kolokvium): 15% Seminaret ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 70%		

	Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	Fiziologjia e bimëve (dispensë ligjëratash) Praktikum i Fiziologjisë së bimëve (dispensë)
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vjollca Ibro: Fiziologjia e bimëve. Universiteti Bujqësor i Tiranës. 2. Lincoln Taiz and Eduardo Zeiger: Plant Physiology, 5th edition, Sunderland, USA, 2010. 3. Denffer Ziegler: Botanika (Morfologjia i Fiziologjia biljaka), Skolska knjiga, Zagreb, 1991. 4. Mohr-Schopfer: Pflanzen Physiologie, Springer-Verlag, Berlin, Hiederberg, New York, Tokyo, 1991.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Objekti i studimit dhe lidhja e Fiziologjisë së bimëve me shkencat tjera. Fiziologjia e qelizës bimore. Membrana citoplazmatike-plazmalema dhe membranat e tjera.
Java e dytë:	Bërthama dhe roli i sajë te qelizat bimore. Mitokondriet. Ribozomet. Retikulumi endoplazmatik.
Java e tretë:	Plastidet: Kloroplastet, karotenoidoplastet, leukoplastet (klasifikimi, shndërrimi dhe funksioni i tyre).
Java e katërt:	Përbërja kimike e protoplazmës. Lëngu qelizor. Produktet tjera të brendshme të protoplastit.
Java e pestë:	Produktet e jashtme të protoplastit: Muri qelizor. Përbërja kimike dhe modifikimet e murit qelizor.
Java e gjashtë:	Regjimi ujqor i bimëve. Proceset që mundësojnë absorbimin dhe transportimin e ujit nëpër bimë. Format e ujit në tokë.
Java e shtatë:	Të liruarit e ujit prej bimës: Transpirimi, gutimi dhe lotimi. Mekanizmi i hapjes dhe mbylljes së gojëzave. Roli biologjik i transpirimit.
Java e tetë:	Ushqimi mineral i bimëve. Metabolizmi i materieve minerale. Elementet makrometabolike dhe mikrometabolike.
Java e nëntë:	Absorbimi, metabolizmi dhe qarkullimi i azotit. Roli fiziologjik i: azotit, fosforit, squfurit, kaliumit, magnezit, kalciumit, hekurit, manganit, borit, zingut, bakrit dhe molibdenit.
Java e dhjetë:	Fotosinteza. Fazat e fotosintezës. Faza fotokimike e fotosintezës (fosforolimi fotosintetik dhe fotoliza e ujit).
Java e njëmbëdhjetë:	Fiksimi i dioksidit të karbonit ose faza biokimike e fotosintezës (faza e errësirës). Kemosinteza. Faktorët që ndikojnë në fotosintezë.
Java e dymbëdhjetë:	Frymëmarrja te bimët. Faza initiale e frymëmarrjes dhe terminale e frymëmarrjes.

Java e trembëdhjetë:	Fosforilimi oksidues. Cikli oksidues fosfopentozik. Matja dhe treguesit e frymëmarrjes. Faktorët që ndikojnë në frymëmarrje.
Java e katërbëdhjetë:	Morfogjeneza. Rritja dhe zhvillimi. Hormonet bimore (fitohormonet): Auksinet, giberelinet, citokininet. Hormonet me veprime inhibitore: etileni dhe acidi abscisik. Substanca të tjera endogjene dhe sintetike të rritjes.
Java e pesëmbëdhjetë:	Ndikimi i faktorëve të jashtëm në rritje dhe zhvillim të bimëve. Fotoperiodizmi. Fiziologjia e rezistencës së bimëve. Lëvizjet e bimëve.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.	

HYRJE NË SHKENCËN BIMORE I

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Bujqesise
Titulli i lëndës:	Bazat e shkences bimore-I-
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Dyte
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	8:30- 11:20/ Fakulteti Bujqesise, No 32
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc.Dr. Sali Aliu
Detajat kontaktuese:	Sali.aliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Permirsimi gjenetik eshte lemi shkencore e biologjise e cila si qellim kryesor ka njihjen e faktoreve klimatik si abiotik dhe biotik, ciklin jetesor te bimes, mjedisi, toka, ushqimi bimeve, masat agroteknike te cilat aplikohen ne prodhimtarine intensive bujqesore.
Qëllimet e lëndës:	Parimet kryesore të shkences bimore do te jene me fokus qe te njihemi me ndikimin e faktoreve mjedisor ne kultura bujqesore, efekti I masava agroteknike,, llojet e plehtave kimike dhe organike. Qarkullimi bimor fushor, rendesia e e rotacionit. Lavrimi,llojet dhe menytrat e aplikimit.Fara dhe koncepti isaj, kategorite e fares bujqesore, Rendimenti si dhe klasifikimi I bimeve lavartare bujqesore si dhe te njihen me legjislativin e BE.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pritjet janë që studentet të janë në gjendje të njohin rolin dhe rendesine e lendes, metodatt, teknikat dhe mjetet te cilat aplikohen .Studente te marin

	iformacion per efektin e faktorev abiotik dhe biotik ne kultura bujqesore, aplikimi i masave agroteknike, perdorimi dhe normimi i fares permbjellje, logaritja e fares dhe plehrave per njesi te siperfaqes, kualiteti fares si mbirja, pastertia, masa 1000 farave, hektolotrike etj		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	4	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	8	8
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	1	4	4
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	4	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	4	4
Përgaditja përfundimtare për provim	1	6	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	8	8
Projektet, prezentimet, etj.	1	10	10
Totali	15	75	150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimet është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me goje.		
Metodat e vlerësimit:	Detyrat - 15% Pjesëmarrja ne ushtrime 2% Testi pare 35% Provimi final 48%		
Literatura			
Literatura bazë:	Aliu S.2012. Bazat e prodhimit bimor ,Prishtine, Ligjerata te autorizuara.		
Literatura shtesë:	Jalokai M. 2002. Crop Production		
Plani i dizajnuar i mësimet:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Rendesia e prodhimit bimor si dhe shfrytezimi tyre ne te		

	ushqyerit human
Java e dytë:	Toka si substrat i kulturave bujqësore: kultivimit dhe trajtimi i tokave në kompleksin e prodhimit bimor.
Java e tretë:	Humusi dhe menaxhimit I lëndëve ushqyese.
Java e katërt:	Klasifikimi I bimeve bujqësore ne aspektin agronomik dhe shperndarja e tyre (drithëra, bimë vajore, bishtajore , zhardhokore, bimet e arava, bimet me destinim special, bimë foragjere, bimet per mbulim te terrenit.)
Java e pestë:	kërkesat e tyre përsa i përket kohës së mbjellëse dhe korrjes. Sistemet e rotacionit te kulturave bujqësore.
Java e gjashtë:	Shfrytëzimi I arave te punueshme, shfrytëzimi I foraxhereve, sistemi foraxher ne ara, rotacioni I bimeve te arave, rotacionit i bimeve bujqësore.
Java e shtatë:	Menaxhimi i sistemeve në drejtim të kultivimit të tokës: kultivimi konvencional, ruajtja , kultivimi nën kushte minimale te rotacionit
Java e tetë:	System rotacionit ne perime.
Java e nëntë:	Vlerësimi kritik i sistemeve të ndryshme të prodhimit te kulturave bujqësore dhe perimeve dhe monokultura.
Java e dhjetë:	Përkufizimet, ndarja e barërave te këqija,përhapja, asociacionet me bimet bujqësore .
Java e njëmbëdhjetë:	Pragu ekonomike
Java e dymbëdhjetë:	Prodhimtaria bimore e qëndrueshëm. bujqësia Konvencionale në BE dhe ne pjesëtjera të botës, bujqësia e integruar, format organike te bujqësisë
Java e trembëdhjetë:	Fara dhe koncepti saj
Java e katërbëdhjetë:	Rajonet e bimëve: zgjedhja e tokës, kërkesat e kushteve klimatike, përgatitja e shtratit te farës, mbjellja, kujdesi, magazinimi. Teknikat e zgjedhjes se terrenit dhe madhësisë se fushes per prodhim
Java e pesëmbëdhjetë:	
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime - rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim - hyrja në sallë me kohë, - shkyçja e telefonave celular	

BAZAT E PEMËTARISË

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti i Shkencave te Prodhimit Bimore
Titulli i lëndës:	Bazat e Pemëtarise
Niveli:	Bachelor

Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II^{te}		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Prishtine		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Sylë Sylanaj		
Detajet kontaktuese:	Zyra nr.37. tel 038-540-846 E-mail: syle.sylanaj@uni-pr.edu ssylanaj@hotmail.com Termini i caktuar për bisedë me studentë: e marte dhe e enjte 11-13 h		
Përshkrimi i lëndës	Përvetësim i njohurive themelore për llojet e pemëve gjegjësisht eksplorimin e vetive të tyre morfologjike, fiziologjike dhe zhvillimin e rritjen e pemëve frutore. Ne këtë modul fitohen njohuri bazike për aplikimin e masave agropomoteknike në pemëtari për mënyrën e kultivimit, përgatitjen e tokës për mbjelljen e fidanëve . Studentet krijojnë një bazë për eksplorimin e pemëve frutore. Si themeli i prodhimit pemëtare është të mësohet dhe të kuptohet se çka duhet të ju ofrohet pemëve në pemishte dhe të sigurohen kushtet e duhura për rritje dhe zhvillim.		
Qëllimet e lëndës:	Studenti fiton njohuri themelore për llojet e pemëve dhe të njohet me biologjin, ekologjin e pemëve. Mëson për mënyrat e shumezimit të pemëve, masat agropomoteknike, ngritjen dhe mirëmbajtjen e pemishtes.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentin do të jetë në gjendje që: të jetë i pavarur në punën e tij për prodhimtarin pemëtare dhe të zbatojë agroteknikat bashkëkohore për kultivim.. 1. Të njoh llojet e pemëve, bazën morfologjike dhe biologjike të tyre, 2. Të njoh mënyrat e shumimit të pemëve dhe infrastrukturën e nevojshme – fidanishtet 3. Njohjen e parimeve të krasitjes dhe format e kurorave të pemëve. 4. Planifikimin, projektimin, ngritjen dhe mirëmbajtjen e pemishteve 5. Vjeljen dhe ruajtjen e frutave		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45

Ushtrime teorike/laboratorike	2	10	20
Punë praktike	2	10	20
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	2	5	10
Kollokfiume,seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	3	5	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia në këtë lëndë është e kombinuar: ligjërata dhe ushtrime. Në ligjërata përdoret metoda interaktive, por pjesa kryesore mbulohet nga ligjërimi i mësimdhënësit. Prezantimi i temës mësimore në Power Point. Në fund të ligjëratave studentët marrin detyra Rast studimi që duhet t'i bëjnë në shtëpi dhe t'i diskutojnë në orën e ushtrimeve.		
Metodat e vlerësimit:	Punimet e pavarura të studentëve gjatë punës së drejtpërdrejtë (gjatë mësimit) marrin pjese në vlerësim me shkrim + me gojë. Përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier e percaktonë vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	1.Efendija T.2000.: Pemetaria e Pergjithshme.Prishtine 2. Zajmi A., Syllanaj S., Berisha A. 2006: Pemetaria Praktike. Prishtine 3. Zajmi A. 1997 : Pemetaria speciale I. Prishtine.		
Literatura shtesë:	1. Shtampar F. et al. 2005: Sadjarstvo. Ljubljana 2 . Syllanaj S. 2004: Dredheza. Gjakove.		

	3. Miljković, I. 1996: Opće voćarstvo, Zagreb, 4. Grup autoresh, 1992: Frutticoltura generale, REDA.
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Rendesia e pemetarisë: Çka është pemëtaria; Rroli dhe detyrat e pemëtarisë; Pemët si produkt; Prodhimtaria e pemëve të ne dhe në bote; Struktura e prodhimitarisë të kulturave pemëtarë; Klasifikimi i pemëve
Java e dytë:	Ekologjia e pemëve: Faktorët klimatik- tokësor në zhvillimin e pemëve
Java e tretë:	Bazat morfologjike të pemëve: Organet e pemëve dhe funksioni i tyre; Organet nëntokësore (sistemi rrënjor); Organet mbitokësore; Degët dhe llojet e degëve; Sythat; gjetet; lulja; fryti dhe fara.
Java e katërt:	Bazat biologjike të pemëve; cikli jetësor; cikli vjetor (periudha e vegjetacionit dhe e qetësisë);
Java e pestë:	Fiziologjia e frutifikimit të pemëve; pjalmimi dhe pllenimi i pemëve; frutdhenja alternative.
Java e gjashtë:	Pleherimi I pemëve: rëndësia e elementeve ushqyese minerale të pemët; llojet e plehrave; koha dhe mënyra e pleherimit të pemëve.
Java e shtatë:	Kolokvijum Vlerësimi i I intermediar.
Java e tetë:	Bazat e shumëzimit të pemëve; Mënyrat e shumëzimit; Kualiteti i fidanëve
Java e nëntë:	Fidanishtja pemëtare;
Java e dhjetë:	Ngritja e pemishteve; Përgatitja e tokës për ngritje të pemishteve; koha e mbjelljes; radhitja e kultivarëve në pemishte; teknika e mbjelljes.
Java e njëmbëdhjetë:	Krasitja e pemëve: krasitja dimërore dhe krasitja e gjelbër
Java e dymbëdhjetë:	Format e kurorave të pemëve; format natyrore, gjysmë të dirigjuara dhe të dirigjuara
Java e trembëdhjetë:	Agroteknika ; mirëmbajtja e tokës në pemishte.
Java e katërbëdhjetë:	Kolokvijum Vlerësimi i II intermediar.
Java e pesëmbëdhjetë:	Kriteret për përcaktimin e vjeljes së frutave dhe ruajtja e frutave:
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes konform statusit të universitetit.	

BAZAT E VRESHTARISË

Të dhëna bazike të lëndës

Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë		
Titulli i lëndës:	“Bazat e Vreshtarisë”		
Niveli:	BSc.		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II^{te}		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Semestri III^{te}		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asc.		
Detajet kontaktuese:	bedri.dragusha@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi “Bazat e Vreshtarisë” ka për qëllim të shpjegoj identifikimin e kushteve më të përshtatshme agroklimatike dhe tokësore për Hardhinë e rrrushit.. Ky kurs ofron njohuri të mjaftueshme për studentët lidhur me Anatominë, Fiziologjinë dhe Biologjinë e Hardhisë së rrrushit. Njohuri të mjaftueshme për njohjen e të gjitha organeve të Hardhisë dhe Fenofazave të zhvillimit të sajë.</p> <p>Njohjen dhe determinimin e nënshartesave dhe varieteteve të Hardhisë së rrrushit.</p> <p>Të jenë në gjendje të kryejnë të gjitha operacionet e nevojshme Agro dhe Vititeknike gjatë tërë vitit.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky kurs ka për qëllim që studentëve të ju ofroj njohuri teorike dhe praktike lidhur me identifikimin e kushteve më të përshtatshme agroklimatike dhe tokësore për ngritjen, kultivimin dhe mirëmbajtjen me sukses të Hardhinë e rrrushit.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikojnë Kushtet e favorshme Klimatike dhe Tokësore për kultivimin e suksesëshëm të Hardhisë së rrrushit • Përcaktojnë teknikat më të përshtatshme për ngritjen e Vreshtave. • Aplikojnë metodat më bashkëkohore për mirëmbajtjen e Vreshtave. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	3	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2	30
Punë praktike	3	8	24

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	8	1	8
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	6	12
Përgaditja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet, etj.	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ky është një kurs i kombinuar Ligjërata-Ushtrime në të cilat temat prezantohen nga Profesori i lëndës. Pjesët praktike, veprimtaritë laboratorike dhe ekskursionet shpjegohen nga profesori dhe asistenti i lëndës. Në përgjithësi prezentimet e ligjëratave do të bëhen përmes Power Pointit. Materiale shtesë do të sigurohet nga Profesori. Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime praktike është obligativ. Verifikimi i njohurive do të kryhet pas përfundimit të cikleve të mësuarit. Pas përfundimit të ligjëratave është pjesë e detyrueshme testimi nëpërmjet kollokviumit përfundimtar dhe provimit me gojë.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv. Vlerësimi i parë: 20 % Vlerësimi i dytë: 20% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 45% Totali 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sotiri P., Gjermani T., Nini T. (1973): Vitikultura. Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë. Tiranë. 2. Petraq Sotiri. (1977): Praktikum i vitikulturës. Instituti i lartë bujqësor. Tiranë. 3. Bashkim Koronica. (1996): Vreshtaria. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë. 4. Isufi E., Kapidani E., Locher E. (2001): 		

	<p>Mbrojtja e hardhisë nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Pegi. Tiranë.</p> <p>5. Todo Gjermeni. (2003): Ampelografi dhe njohuri praktike mbi kultivarët kryesor të rrushit. Shoqata e bujqësisë organike. Tiranë.</p> <p>6. Shundi A., Daçi A., Neranxi N. (2003): Vreshtaria praktike. Albgraf. Tiranë.</p> <p>7. Shundi A., Daçi A. (2006): Fjalor shtjellues vreshtaria dhe verëtaria. Albgraf. Tiranë.</p> <p>8. Lush Susaj. (2008): Dëshmi mbi historinë e kultivimit të hardhisë nga gadishulli Ilirik. Art-Grafik. Tiranë.</p> <p>9. Agan Kojic. (2000): Vinogradarstvo. Studentska stamparija Universiteta Sarajevo. Sarajevë.</p>
Literatura shtesë:	<p>1. Kispatic J., Maceljski M. (1991): Zastita vinove loze. Nakladni zavod znanja. Zagreb.</p> <p>2. Larry E. Williams., Michael G. Mullins., Alain Bouquet. (1992): Biology of the Grapevine. Cambridge University Press.</p> <p>3. W. M. Kliwer., James A. Cook., Albert Julius Winkler. (1975): General Viticulture. University of California Press.</p> <p>4. Lon Rombough. (2002): The Grape Grower: A Guide to Organic Viticulture. Chelsea Green Pub Co.</p> <p>5. Lazar Avramov. (1991): Vinogradarstvo. Nolit. Beograd.</p>
Plani i dizejnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e pare:	Vreshtaria, objekti i studimit, historiku, prejardhja e hardhisë së rrushit. Vreshtaria në botë dhe në Kosovë.
Java e dytë:	Rëndësia e rrushit dhe produkteve të tijë Rajonizimi i vreshtarisë në Kosovë
Java e tretë:	Sistematika e hardhisë së rrushit
Java e katërt:	Organografia - Organet e hardhisë së rrushit
Java e pestë:	Fenofazat e rritjes dhe zhvillimit të Hardhisë së rrushit
Java e gjashtë:	Biologjia e Hardhisë së rrushit
Java e shtatë:	Fiziologjia e Hardhisë së rrushit
Java e tetë:	Shumëzimi i hardhisë së rrushit
Java e nëntë:	Nënshartesat e Hardhisë së rrushit
Java e dhjetë:	Varietetet e Hardhisë së rrushit
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemet e ngritjes së Hardhisë së rrushit
Java e dymbëdhjetë:	Krasitja e hardhisë së rrushit

Java e trembëdhjetë:	Mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtuesit
Java e katërbëdhjetë:	Përbërja kimike e rrushit dhe caktimi i momentit optimal për vjeljen e rrushit
Java e pesëmbëdhjetë:	Vjelja, transporti dhe ruajtja e rrushit
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> - vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime - rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim - hyrja në sallë me kohë, - shkyçja e telefonave celular. 	

Semestri IV

HYRJE NË PËRMIRËSIMIN GJENETIK TË BIMËVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Bujqesise
Titulli i lëndës:	Permirsimi gjenetik i bimeve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Dyte
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	8:30- 11:20/ Fakulteti Bujqesise, No 32
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc.Dr. Sali Aliu
Detajet kontaktuese:	Sali.aliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Permirsimi gjenetik është lëmi shkencore e biologjise e cila si qëllim kryesor ka krijimin, permirsimin e kultivareve të rinje me qëllim të rritjes së rendimentit si në aspektin sasior ashtu edhe atë cilësor. Lënda kryesisht ka të bëjë me përshkrimin e ligjeve baze të trashëgueshmërisë, ndikimit të faktoreve të jashtëm përfshirë ato biotik dhe abiotik, të cilët kanë një impact shumë të lartë në strukturën gjenetike apo në konstitucionin gjenetik të bimës. Përshkrimi si dhe pajisjet teknike për realizim të metodave të cilat aplikohen në krijim të kultivareve të rinje. Inbridingun, heterozisin, kultivaret, mirembajtja e tyre.
Qëllimet e lëndës:	Parimet kryesore të permirsimit gjenetik të bimëve

	do të jene me fokus që të analizohet variabiliteti gjenetik, burimet e e ketij variacioni ,metodat e krijimit të kultivareve të rinje, permirsimi I kultivareve ekzistues , biologjia e bimeve autogame dhe ksenogamve, tiparet sasiore dhe cilësore, heritabiliteti, fenotipi dhe gjenotipi, Dizajni I fushave eksperimentale dhe futja e të dheneve statistikore, interpretimi tyre, inbridingy dhe heterozisi, seleksionimi adaptive, krijimi I kultivareve rezistent ndaj semundjeve dhe demtuesve, mutacionet, apomiksia, poliploidia, hibridizimi, teknikat e hibridizimit etj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pritjet janë që studentet të janë në gjendje të njohin rolin dhe rëndesinë e lëndës, metdoat, teknikat dhe mjetet që cilat nevojiten në programe të permirsimit gjenetik të bimeve,mutacionet, natyrën e bimeve autogame, ksenogame. Studentet duhet të njohin në tërësi procesin einbridingut dhe të heterozisit.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	4	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	8	8
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	1	4	4
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	4	4
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	4	4
Përgaditja përfundimtare për provim	1	6	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	8	8
Projektet, prezentimet ,etj	1	10	10
Totali	15	75	150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimimit është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me gojë.		

Metodat e vlerësimit:	Detyrat - 15% Pjesëmarrja ne ushtrime 2% Testi pare 35% Provimi final 48%
Literatura	
Literatura bazë:	Aliu S.2012. Bazat e permirsimit gjenetik te bimeve,Prishtine, Ligjerata te autorizuar.
Literatura shitesë:	Chahal, Gosal: Principles and procedures of plant breeding. 604 p. Alpha Science, 2002. ISBN: 1-84256-036-X Additional literature: Kukuck, Kobabe, Wenzel: Fundamentals of plant breeding. 236 p. Springer Verlag, 1991. ISBN: 3-540-52109-7 Singh, Dasgupta, Tripathi: Hybrid vegetable development. 441 p. Hawarth Press, 20052005 ISBN: 1560221186
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Historia e permirsimit gjenetike te bimeve. Burimet e variacionit gjenetik, konservimi dhe organizimi i bankes se gjeneve.
Java e dytë:	Baza gjenetike ebimeve . Reprodukimi bimeve, polenzimi dhe pllenimi, mikro dhe makrosporogjeneza,
Java e tretë:	Baza gjenetike e bimeve autogame-metodat
Java e katërt:	Baza gjenetike e bimeve ksenogame-metodat
Java e pestë:	Burimet e variacionit gjenetik, Rekombinimi gjeneve, mutacionet, transferi i gjenit, variabiliteti somaklonial, transgresionet
Java e gjashtë:	Vecoria, gjenotipi dhe fenotipi
Java e shtatë:	Menyrat e seleksionimi te bimeve
Java e tetë:	Koncepti I krijimit ten je kultivari te ri
Java e nëntë:	Trashegimi I vecorive sasiore dhe cilesore
Java e dhjetë:	Polyploidia
Java e njëmbëdhjetë:	Rendesia e inbridingut
Java e dymbëdhjetë:	Rendesia e heterozisit.
Java e trembëdhjetë:	Permirsimi gjenetik i bazuar ne qendrueshmeri te bimeve
Java e katërbëdhjetë:	Koncepti kultivarit dhe legjislacioni
Java e pesëmbëdhjetë:	Krijimi i haploideve te dyfishte
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime - rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim - hyrja në sallë me kohë, - shkyçja e telefonave celular	

BAZAT E AKAROLOGJISË DHE NEMATOLOGJISË

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Bazat e Akarologjisë dhe Nematologjisë
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	4+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri V
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr. Fadil Musa
Detajet kontaktuese:	fadil.musa@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kursi nga bazat e Akarologjisë dhe Nematologjisë ka për qëllim që të shpjegon problemet dhe principet themelore të akarologjisë dhe nematologjisë, taksonominë e merimangave dhe nematodeve, morfologjinë dhe biologjinë e merimangave dhe nematodeve. Lënda përfshin njohjen bazike të Ekologjisë së merimangave dhe nematodeve (marrëdhëniet ndër llojore; efektet e faktorëve abiotikë, strukturat e populacioneve, numri dhe dinamika e populacioneve). Gjithashtu, studentët duhet të njoftohen me dëmtuesit kryesor në kulturat e ndryshme bujqësore nga radhët e merimangave dhe nematodeve, masat parandaluese dhe të kontrollit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i modulit është ofrimi i njohurive teorike, praktike dhe shkencore për merimangat dhe nematodet dëmtues të kulturave bujqësore. Të shpjegohet taksonomia, morfologjia dhe biologjia e merimangave dhe nematodeve. Dëmtuesit kryesor në kulturat e ndryshme bujqësore nga merimangat dhe nematodet si dhe dëmet e shkaktuara së bashku masat kryesore për menaxhimin e këtyre dëmtuesve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të njohin dhe të gjykojnë rolin e merimangave dhe nematodeve që paraqiten në kulturat bujqësore. 2. Të njohin ekologjinë dhe biologjinë e merimangave dhe nematodeve dhe determinimin e tyre. 3. Të njohin masat kryesore për menaxhimin e merimangave dhe nematodeve në kulturat

bujqësore.			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	4	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	3	8	24
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	8	1	8
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	6	12
Përgatitja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	1	5	5
Totali			165
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimit është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike (insektarium dhe herbarium) dhe provimi përfundimtarë me gojë.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Studentet duhet të jetë i afte për punë ekipore, për zhvillimin e mendimit kritike dhe kreative si dhe për prezantimin e njohurive të fituara në kuadër të lëndës.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv.</p> <p>Vlerësimi i parë: 30 % Vlerësimi i dytë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Totali 100%</p>		
Literatura bazë:	Dobrivojević, K & Radmila Kapetanović (1982): Osnovi Akarologije. Beograd.		

	<p>Festić, H. 1996. Poljoprivredna Entomologija. Universitetska knjiga. Sarajevo</p> <p>Jovani, V. (2011): Nematodat e bimëve dhe kontrolli i tyre. Tiranë.</p> <p>Kišpatić, J. & Maceljki, M. 1989. Zaštita voćaka od bolesti, štetnika i korova. Nakladni Zavod Znanje. Zagreb.</p> <p>Maceljki, M. 1999. Poljoprivredna Entomologija. Zrinski. Čakovec.</p> <p>Maceljki, M., B. Cvjetković, Z. Ostojić, Jasminka Igrc-Barčić, Nedeljka Pagliarini, Ljerka Oštrec & Ivanka Čizmić. 1997. Zaštita povrća od štetočina. Znanje d.d. Zagreb.</p> <p>Stirling, G., Julie Nicol & Reay, F. (2002): Advisory Service for Nematode Pests. Rural Industries Research and Development Corporation. Moggill Road.</p> <p>Susuri, L. & Pireva, I. (1986): Mbrojtja e bimëve, Prishtinë.</p>
Literatura shtesë:	<p>Pireva, I. 1996. Entomologjia e Përgjithshme. Universiteti i Prishtinës. Fakulteti i Bujqësisë Prishtinë.</p> <p>Stani, A. & Murraj, Xh. (1975): Entomologjia bujqësore (Pjesa e veçantë), Dispensat I, II dhe III, Tiranë.</p>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Rëndësia , ndarja dhe përhapja e merimangave dhe nematodeve
Java e dytë:	Morfologjia, anatomia dhe fiziologjia e merimangave
Java e tretë:	Biologjia dhe ekologjia e merimangave
Java e katërt:	Klasifikimi i merimangave dëmtues të kulturave bujqësore.
Java e pestë:	Merimangat si dëmtues të kulturave bujqësore
Java e gjashtë:	Izolimi dhe diagnostifikimi i merimangave
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë me shkrim
Java e tetë:	Morfologjia dhe veçoritë themelore të nematodeve
Java e nëntë:	Biologjia dhe shumimi i nematodeve
Java e dhjetë:	Bazat e sistematikës së nematodeve
Java e njëmbëdhjetë:	Ekologjia e nematodeve
Java e dymbëdhjetë:	Nematodet dëmtues të kulturave bujqësore
Java e trembëdhjetë:	Izolimi dhe diagnostifikimi i nematodeve
Java e katërbëdhjetë:	Masat për menaxhimin e merimangave dhe nematodeve në kulturat bujqësore
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë me shkrim
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	

- vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime
- rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim
- hyrja në sallë me kohë,
- shkyçja e telefonave celular

BAZAT E AMPELOGRAFISË

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	“Ampelografia”
Niveli:	BSc.
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II^{te}
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri IV^{te}
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asc.
Detajet kontaktuese:	bedri.dragusha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	
	<p>Kursi “Ampelografia” ka për qëllim të bëjë përshkrimin e nënshartesave dhe varieteteve të Hardhisë së rrushit dhe identifikimin e tyre.</p> <p>Ky kurs ofron njohuri të mjaftueshme për kompatibilitetin mes nënshartesave dhe varieteteve të Hardhisë së rrushit.</p> <p>Njohuri të mjaftueshme për përshtatshmërinë e varieteteve në kushtet agro klimatike dhe tokësore të Kosovës.</p>
Qëllimet e lëndës:	
	<p>Ky kurs ka për qëllim që studentëve të ju ofroj njohuri teorike dhe praktike lidhur me identifikimin e nënshartesave dhe varieteteve më të përshtatshme për kultivim në kushtet agro klimatike dhe tokësore të Kosovës.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	<p>Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikojnë Kushtet e favorshme agro klimatike dhe tokësore për kultivimin e suksesëshëm të varieteteve të Hardhisë së rrushit • Përcaktojnë teknikat më të përshtatshme për secilin varietet veq e veq. • Aplikojnë metodat më bashkëkohore për mirëmbajtjen e Vreshtave.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	3	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2	30
Punë praktike	3	8	24
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	8	1	8
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	6	12
Përgaditja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet, etj.	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ky është një kurs i kombinuar Ligjërata-Ushtrime në të cilat temat prezantohen nga Profesori i lëndës. Pjesët praktike, veprimtaritë laboratorike dhe ekskursionet shpjegohen nga profesori dhe asistenti i lëndës. Në përgjithësi prezantimet e ligjëratarave do të bëhen përmes Power Pointit. Materiale shtesë do të sigurohet nga Profesori. Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime praktike është obligativ. Verifikimi i njohurive do të kryhet pas përfundimit të cikleve të mësuarit. Pas përfundimit të ligjëratarave është pjesë e detyrueshme testimi nëpërmjet kollokviumit përfundimtar dhe provimit me gojë.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv. Vlerësimi i parë: 20 % Vlerësimi i dytë: 20% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 45% Totali 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Sotiri P., Gjermani T., Nini T. (1973): Vitikultura. Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë. Tiranë. 2. Petraç Sotiri. (1977): Praktikum i vitikulturës.		

	<p>Instituti i lartë bujqësor. Tiranë.</p> <p>3. Bashkim Koronica. (1996): Vreshtaria. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë.</p> <p>4. Todo Gjermeni. (2003): Ampelografi dhe njohuri praktike mbi kultivarët kryesor të rrushit. Shoqata e bujqësisë organike. Tiranë.</p> <p>5. Agan Kojic. (2000): Vinogradarstvo. Studentska stamparija Universiteta Sarajevo. Sarajevë.</p>
Literatura shtesë:	<p>6. W. M. Kliewer., James A. Cook., Albert Julius Winkler. (1975): General Viticulture. University of California Press.</p> <p>7. Lon Rombough. (2002): The Grape Grower: A Guide to Organic Viticulture. Chelsea Green Pub Co.</p> <p>8. Lazar Avramov. (1991): Vinogradarstvo. Nolit. Beograd.</p>

Plani i dizajnuar i mësim:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e pare:	Sistematika e hardhisë së rrushit
Java e dytë:	Familja Vitaceae
Java e tretë:	Gjinia Vitis
Java e katërt:	Faktoret ekologjik
Java e pestë:	Shumëzimi i hardhisë së rrushit
Java e gjashtë:	Përgatitja e tokës për ngritjen e Vreshtit
Java e shtatë:	Teknikat e mbjelljes
Java e tetë:	Format e kurorave – sistemet e ngritjes
Java e nëntë:	Punët në tri vitet e para të ngritjes së vreshtit
Java e dhjetë:	Nënshartesat e Hardhisë së rrushit
Java e njëmbëdhjetë:	Nënshartesat e Hardhisë së rrushit
Java e dymbëdhjetë:	Klasifikimi varieteteve të hardhisë
Java e trembëdhjetë:	Varietetet e Hardhisë së rrushit për Verë
Java e katërbëdhjetë:	Varietetet e Hardhisë së rrushit për Tryezë
Java e pesëmbëdhjetë:	Varietetet e Hardhisë së rrushit për Tharje - terje
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> - vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime - rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim - hyrja në sallë me kohë, - shkyçja e telefonave celular. 	

HYRJE NË SHKENCËN BIMORE II

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Bujqesise
Titulli i lëndës:	Hyrje ne shkencen bimore II
Niveli:	Bachelor

Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Dyte		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	8:30- 11:20/ Fakulteti Bujqesise, No 32		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Imer Rusinovci		
Detajet kontaktuese:	Imer.rusinovci@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Ky është një kurs i përgjithshëm arsimor që ofron njohuri të përgjithshme të shkencës bimërore për dy aspekte kuptuar më mirë shkencën e bimëve dhe për studime të mëtejshme në çdo disiplinë shkencore bimërore, duke përfshirë bujqësinë. Ky kurs është i dizajnuar për të ofruar shumë aspekte themelore dhe aplikative të shkencës bimërore dhe bujqësisë.		
Qëllimet e lëndës:	Objektivat kryesorë të lëndës "Hyrje në shkencën e bimëve II" është që të ofrojë njohuri në lidhje me situatën e kulturave bimërore në terren dhe tendencat e tyre në mbarë botën. Prodhimet bujqësore, klasifikimi, origjina dhe shpërndarja. Kulturat bujqësore, të lashtat, bimë foragjere, bimët vajore, bimë medicinale dhe aromatike, bimë fibër, bimë në prodhimin e niseshtes, sheqerit dhe alkoolit. Prodhimi, menaxhimi gjatë vegjetacionit, korrjes-shirja, menaxhimi pas korrjes . Përdorimi i të lashtave dhe rëndësinë e tyre për qeniet njerëzore. Njohjen e marrëdhënieve ekologjike midis organizmave dhe mjedisit të tyre dhe sfidat e shkaktuara nga intensifikimi i prodhimit të ushqimit për të ushqyer popullatën në rritje.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët do të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike në lidhje me shkencën dhe kërkimin shkencor. Identifikimin e pjesëve të bimëve dhe funksionet. Mësojnë grupet kryesore bimërore, me theks të veçantë kulturat bujqësore më të rëndësishme. Kuptojnë dhe të kryejë procedurat bazë bujqësore në mënyrë të sigurt.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	8	8
Kontaktet me	1	4	4

mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren	1	4	4
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	4	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	4	4
Përgaditja përfundimtare për provim	1	6	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	8	8
Projektet, prezentimet, etj.	1	10	10
Totali	14	80	125
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimin është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me goje.		
Metodat e vlerësimit:	Detyrat - 15% Pjesëmarrja ne ushtrime 2% Testi pare 35% Provimi final 48%		
Literatura			
Literatura bazë:	Archie Dell Wilson, Clyde William Warburton, 2008. Field Crops (1912). Kessinger Publishing, 548 p., ISBN 1436846056 Group of authors. 1997. Fitoteknia, Tirane Rusinovci, I. 2005. Bimët e arave (dispense), Prishtine.		
Literatura shtesë:	Tajnšek A. 1991. Koruza. ČZP Kmečki glas, Ljubljana, 180 p., no ISBN Tajnšek A. 1988. Pšenica. ČZP Kmečki glas, Ljubljana, 162 p., no ISBN Internet resources.		
Plani i dizajnuar i mësimin:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Hyrje dhe përkufizimi i kulturave bimore në terren, si dhe përbërja e zhvillimi i kulturave bimore.		
Java e dytë:	Kulturat bimore (lavërtare-perimore) ne botës me theks mbi situatën në Kosovë dhe rajon (Sipërfaqet, karakterizimi në lidhje me vegetacionin dhe përdorim).		
Java e tretë:	Profilet e klasifikimit shkencor dhe përcaktimi i llojeve të kulturave kryesore.		

Java e katërt:	Përmbledhje e shkurtër e të lashtave tjera.
Java e pestë:	Roli i prodhimit të kulturave bimore për ushqim dhe bujqësi.
Java e gjashtë:	Karakteristikat e prodhimit të kulturave bimore (rendimenti dhe cilësia me termat e kushteve mjedisore dhe teknologjike).
Java e shtatë:	Drithërat. Origjina dhe përshkrimi. Klasifikimi. Rëndësia. Toka dhe plehrat. Përgatitja e tokës. Përgatitja e farës për mbjellje. Mbjellja. Kultivimi. Korrje. Marketing dhe te ardhurat. Përzgjedhja e farës. Ruajtja e farës. Përmirësimi.
Java e tetë:	Përdorimi i shumanshëm i drithërave
Java e nëntë:	Kulturat foragjere.
Java e dhjetë:	Bimë vajore.
Java e njëmbëdhjetë:	Bimët medicinale dhe aromatike.
Java e dymbëdhjetë:	Bimët për prodhimin e fibrave.
Java e trembëdhjetë:	Bimët për prodhimin e sheqerit, niseshte dhe alkoolit.
Java e katërbëdhjetë:	Qarkullimi bimor-përparësitë. Efekti mbi gjendjen fizike të tokës. Mbjajtja nën kontroll e barojave. Efekti në korrje-shirje. Shpërndarja e punës në ferme. Raporti i pjellorisë së tokës.
Java e pesëmbëdhjetë:	Klasat e të lashtave. Çfarë bimët të kultivohen? Aplikimi i plehut organik. Rotacionet për seksione të ndryshme.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>vijim i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime</p> <ul style="list-style-type: none"> - rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim - hyrja në sallë me kohë, - shkyçja e telefonave celular 	

LËNDË ZGJEDHORE NGA LAVËRTARIA (BIOTEKNOLOGJIA E BIMËVE)

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Hyrje në Bioteknologji të bimëve
Niveli:	BSc
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti dytë. Semestri katërt (IV)
Numri i orëve në javë:	3 +2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Enjte : 8:00 – 12:00 // FAV
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Shukri Fetahu
Detajet kontaktuese:	shfetahu@hotmail.com dhe shukri.fetahu@uni-pr.edu Banka Gjenetike e Kosovës- Resurset Bimore.
Përshkrimi i lëndës	

Qëllimet e lëndës:	<p>Studentët kanë njohuritë themelore për Bioteknologji moderne dhe në të kaluarën. Studentët kanë një kuptim të qartë për markerët gjenetikë molekularë, bimët gjenetiksht të modifikuara .</p> <p>Studentët do të një pasqyrë të qartë për përdorimin e tyre dhe rregullat e ndryshme, si dhe për bio-farmingun.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Demonstronjë rëndësinë e OMGJ-ve. ➤ Për të siguruar një pasqyrë të markerëve molekularë që përdoren në Bioteknologji të bimëve. ➤ Njohuri për standardet dhe ligjet e aplikimit dhe përdorimit të OMGJ-ve. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0	0	0
Ushtrime në teren	2	2	4
Kollokfiume,seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	0	0	0
Koha e studimit vetanake të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet ,etj	1	1	1
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata, ushtrime teorike dhe laboratorike, seminar prezantimi, diskutime, duke punuar në grup, vizitë fusha eksperimentale, fidanishte serra eksperimentale etj.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i suksesit të studentëve do të kryhet me pyetësorin - testet dhe përgjigje me gojë si provimin përfundimtar.</p>		

	<p>Përfundim i punës në laborator. Provim në dy pjesë me test dhe me gojë si përfundimtare.</p> <p>Pyetësi, caktohet nga profesori sipas orarit të performancës së kursit mësimor.</p> <p>Vlerësimi Test:</p> <p>Vlerësimi i parë: 30%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 25%</p> <p>Detyrat dhe angazhime tjera: 10%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi përfundimtar: 30%</p> <p>Total 100%</p> <p>Një student i cili ka grumbulluar 60% të pikëve në testin kalon për tre mandate. Pjesa me gojë kalon notat 6 deri 10 (gjashtë dhjetë).</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Chawla H.S., Introduction to plant biotechnology. 2002. Science Publisher, Inc, Plymouth. 539 p. ISBN: 1-57808-228-5 2. Salillari, A., Fetahu Sh, Aliu, S., Susaj L. (2003); Bioteknologjia, Prishtinë. 3. Neal, C. Stewart JR. (2008): Plant Biotechnology and Geneics. Principles, Techniques, and Applications. John Wiley & Sons, Inc. New Jersey.
Literatura shtesë:	Bohanec B., Javornik B., Strel B. 2004. Gensko spremljena hrana. Biotechnical Faculty, Ljubljana. 167 p. ISBN: 961-6379-06-2.

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Bioteknologjia Moderne, në të kaluarën, tash dhe në të ardhmen.
Java e dytë:	Gjenomat e bimëve, qasja në studimet e bimëve.
Java e tretë:	Markerët gjenetikë: analiza molekulare e detektimit të polimorfizmit.
Java e katërt:	Aplikacionet e markerëve gjenetike në ADN dhe metoda fingerprinting
Java e pestë:	Vlerësimin e diversitetit gjenetik,
Java e gjashtë:	Vlerësimi dhe menaxhimi i burimeve gjenetike dhe diagnostifikim të patogjenëve bimore
Java e shtatë:	Kulturat e indeve bimore: mikroshumimi
Java e tetë:	Prodhimi i bimëve të pa viruse
Java e nëntë:	Gjenet dhe transformimet:
Java e dhjetë:	Bimët gjenetike të modifikuara rezistente ndaj viruseve dhe dëmtuesve dhe tolerante ndaj herbicideve
Java e njëmbëdhjetë:	Pasqyra e tipareve më të përshtatshme për transformim

	gjenetik: pjekuria, cilësia e vajrave, përmbajtja e makro dhe mikro- elementeve
Java e dymbëdhjetë:	Rezistenca ndaj stresit abiotike dhe biotike dhe bio faring
Java e trembëdhjetë:	Bio sigurinë e bimëve të modifikuara gjenetikiisht
Java e katërbëdhjetë:	Pasqyrë e dokumenteve relevante ndërkombëtare të rregullimit në Bioteknologji (përmbajtja e përdorimit dhe përhapjes së OMGJ-ve,) dhe harmonizimi i tyre. Rregullat Kombëtare të organizmave të modifikuar gjenetikiisht
Java e pesëmbëdhjetë:	Rëndësia e opinionit publik dhe pranimi i bimëve të modifikuara gjenetikiisht
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Rregullat akademike ", studentët-mësues" respekt reciprok.</p> <p>Pjesëmarrja aktive dhe e rregullt në ligjërata, ushtrime, punë praktike dhe eksperimentale.</p> <p>Puna në grupe të vogla apo të mëdha, komunikim dhe mjetet informative përdorim më të përshtatshme për studentët.</p> <p>Nxitja hulumtim profesional shkencor, pjesëmarrja në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare, publikimet e bashkëpunimit dhe aktiviteteve shkencore.</p> <p>Promovimi dhe nxitja e kërkimit dhe puna krijuese në Bioteknologji të bimëve.</p>	

Semestri V

HYRJE NË MBROJTJE TË BIMËVE I

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Hyrje në Mbrojtjen e bimëve I (Fitofarmacit dhe Fitopatologji)
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	4+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri V
Mësimdhënësi i lëndës:	Kordinator i lëndës: Prof.dr. Adem Demaj Prof.ass.dr. Fadil Musa
Detajat kontaktuese:	adem.demaj@uni-pr.edu dhe fadil.musa@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Mësimi nga lënda hyrje në Mbrojtje të bimëve I (Bazat e Fitofarmacisë dhe Bazat e Fitopatologjisë) ka për qëllim të shpjegoj problemet dhe principet themelore të mjeteve për mbrojtjen e bimëve. Pesticidet të cilat përdoren në bujqësi dhe në degët

	<p>tjera të veprimtarisë së njeriut dhe bazat e toksikologjisë bujqësore. Gjithashtu, do të shpjegohen efektet e dëmshme të materieve kimike në sistemet biologjike, si dhe veprimi dhe mekanizmi i veprimit të tyre në qelizat e gjalla dhe inde, reagimi eisistemeve të gjalla me toksikant si dhe detektimi, identifikimi dhe përcaktimi i mbetjeve të materieve toksike-MRL. Masat mbrojtëse në kuadër të mbrojtjes së bimëve.</p> <p>Në kuadër të Fitopatologjisë do të shpjegohen historiku, zhvillimi, koncepti dhe klasifikimi i sëmundjeve, siptomat e sëmundjeve. Taksonomia e kërpudhave, baktereve dhe viruseve fitopatogjene. Tiparet biologjike të kërpudhave baktereve dhe viruseve fitopatogjene. Fazat e zhvillimit të sëmundjeve dhe ndikimin e faktorëve ekologjik në patogjenezë. Sëmundjet abiotike. Sëmundje të shkaktuara nga faktorë të abiotik (çrregullime ushqimore, stresi mjedisor, ndotja e ajrit etj.). Dëmet tipike dhe simptomat e shkaktuara nga patogjenet, bakteriet, viruset në bimët e kultivuara dhe në depo. Riprodhimi i patogjeneve, përhapja, dhe transmetimi i tyre. Sëmundjet e ndryshme të bimëve, përshkrimi i tyre dhe masat parandaluese dhe të kontrollit.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është të shpjegohen produktet për mbrojtjen e bimëve si dhe efekti i tyre në mjedis. Gjithashtu të analizohet edhe mekanizmi i veprimit të pesticideve në sistemet biologjike. Masat kryesore për menaxhimin e agjentëve të dëmshëm biologjik. Ofrimi i njohurive për Mikologjinë. Për sistematikën dhe nomenklaturën e kërpudhave. Konceptet e rëndësishme paraqitën me ndihmën e shembujve nga problemet ekzistuese nga sëmundjet kryesore. Shumëzimi i kërpudhave. Fiziologjia dhe ekologjia e kërpudhave. Sëmundjet kryesore të kulturave të ndryshme bujqësore të cilat kultvohen në vendin tonë.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Të njohin dhe të gjykojnë rolin e pesticideve dhe efektin e tyre në sistemet biologjike si dhe sëmundjet kryesore që paraqiten në kulturat bujqësore. 5. Të njohin masat kryesore për menaxhimin e agjentëve të dëmshëm biologjik dhe me saktësi të

	<p>madhe të jenë në gjendje që ti determinojnë sëmundjet kryesore që prekin kulturat bujqësore.</p> <p>6. Të njohin mekanizmin e verpimit të pesticideve dhe riprodhimin, përhapjen dhe transmetimin e patogjeneve.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	4	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	3	8	24
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	8	1	8
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	6	12
Përgatitja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Totali			165
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimin është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me gojë.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Studentët duhet të jenë të aftë për punë ekipore, për zhvillimin e mendimit kritike dhe kreative si dhe për prezantimin e njohurive të fituara në kuadër të lëndës.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv.</p> <p>Vlerësimi i parë: 30 % Vlerësimi i dytë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Totali 100%</p>		

Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Demaj, A. (2003): Mbrojtja e ambientit të njeriut. Ligjërata të autorizuara. Fakulteti i Bujqësisë Prishtinë-(skript). 2. Rozhaja, D. dhe Jablanoviq, M. (1983) : Ndotja dhe mbrojtja e ambientit jetësor. Universiteti i Kosovës. Prishtinë. 3. Miloseviq, M., Vitoroviq S. (1992): Osnovi toksikologije. Naucna knjiga. Beograd. 4. Klaasen, C.D., Amadur, O.M., Doull, J. (1986): Casarett and Doull's Toxicology. Third Edition. Macmillan Publishing company. New York. 5. Susuri, L. & Myrta, A. (2012): Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhis së rrushit. Prishtinë. 6. Myrta, A. (2013): Bazat e Virusologjisë Bimore. ADDA Editore. Itali. 7. Susuri, L. (2004): Fitopatologjia. Prishtinë. 8. Marić, A. 1991. Opšta Fitopatologija. Novi Sad.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Biba, N (1992): Toksikologjia veterinare. Tiranë. 1992 2. Kljaiq, R. (1971): Pesticidi. dispencë. Fakulteti i bujqësisë. Beograd. 3. Hadzovic S. (1986): Opca farmakologjia i toksikologjia. Svjetlost. Sarajevo. 4. Numić, R. (1995): Fitopatologjia. Opći dio. Univerzitetaska knjiga. Sarajevo.

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Lënda dhe detyrat e fitofarmacisë.
Java e dytë:	Metodat e mbrojtjes së bimëve
Java e tretë:	Pesticidet dhe toksikantet tjerë si sisteme disperse
Java e katërt:	Klasifikimi ndarja e pesticideve (kriteret për ndarjen e pesticideve)
Java e pestë:	Vetitë fizike të pesticideve dhe lënda e toksikologjis
Java e gjashtë:	Fenomeni i rezistencës së patogjenëve, dëmtuesve dhe barërave të këqija në veprimin e pesticideve.
Java e shtatë:	Rreziku i drejtpërdrejt nga pesticidet dhe shmangia e rrezikut.
Java e tetë:	Historiku, Zhvillimi, Koncepti dhe Klasifikimi i sëmundjeve të kulturat bujqësore.
Java e nëntë:	Taksonomia e kërpudhave, baktereve dhe viruseve fitopatogjeve.
Java e dhjetë:	Tiparet biologjike të kërpudhave, baktereve dhe viruseve.

Java e njëmbëdhjetë:	Fazat e zhvillimit të sëmundjeve dhe ndikimi i faktorëve ekologjik në patogjenezë.
Java e dymbëdhjetë:	Sëmundjet e shkaktuara nga kërpudhat të kulturat lavértare dhe perimore.
Java e trembëdhjetë:	Sëmundjet e shkaktuara nga kërpudhat të kulturat pemtare dhe hardhia e rrushit.
Java e katërbëdhjetë:	Sëmundjet e shkaktuara nga bakteret, viruset dhe patogjenët e tjerë të kulturat bujqësore.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi me test
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> - vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime - rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim - hyrja në sallë me kohë, - shkyçja e telefonave celular 	

PEMËTARIA SPECIALE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti i Shkencave të Prodhimit Bimore
Titulli i lëndës:	Pemetaria Speciale
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III^{te}
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Prishtine
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Sylë Sylanaj
Detajet kontaktuese:	Zyra nr.37. tel 038-540-846 E-mail: syle.sylanaj@uni-pr.edu ssylanaj@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Kjo lende pason pas marrjes së informacioneve mbi pemetarinë e përgjithshme. Pemetaria speciale – Pomologjia merret me problemet e llojeve dhe kultivareve të ndryshme të pemeve, diskuton origjinën, kushtet e prodhimit, karakteristikat biologjike, nenshertesat, llojet, forma e kultivimit, dendësinë e mbjelljes, krasitja për secilin lloj të pemeve (mollë, dardhë, ftua, pjeshke, kajsi, kumbull, qershi, vishnje, arre, lajthi, gështenjë, bajame, dredheze, rrush serez, mjeder, manaferrë, bronicë, kivi, fiku, shega, ullinj, agrume).
Qëllimet e lëndës:	Nga kjo lende studenti merr njohuri të detajuara të mbarështimit-kultivimit të llojeve dhe kultivareve

	të pemeve që janë rritur kryesisht në këto zona, që do të thotë se ata marrin Informacione mbi nenshartetat dhe kultivaret, kushtet agroekologjike, por edhe mbi karakteristikat e caktuara specifike biologjike, format e krasitjes, dendësinë e mbjelljes për llojet e kultivaret e ndryshme të pemeve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të arrij: 1.Të njohë kërkesat specifike të llojeve të ndryshme të pemëve ndaj kushteve klimatiko tokësore 2.Ti njohë kërkesat specifike të llojeve të ndryshme të pemëve, kultivarëve dhe nënshartesave ndj masave agro-pomoteknike që duhet zbatuar 3.Ti njohë tiparet specifike të llojeve të ndryshme të pemëve dhe kultivarëve (produktivitetin dhe cilësinë e frutave) të cilat i bëjnë të përshtatshme për treg.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	10	20
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	1	2	10
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	1	2
Projektet, prezentimet, etj.	2	4	8
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia në këtë lëndë është e kombinuar: ligjërata ushtrime dhe punë praktike. Në ligjërata përdoret metoda interaktive, por pjesa kryesore mbulohet nga ligjërimi i mësimdhënësit. Prezantimi i temës mësimore në Power Point. Në fund të ligjëratave studentët marrin detyra Rast studimi që duhet t'i bëjnë në shtëpi dhe t'i diskutojnë në orën e
-------------------------------------	---

	ushtrimeve dhe gjate punes praktike.
Metodat e vlerësimit:	Punimet e pavarura të studentëve gjatë punës së drejtpërdrejtë (gjatë mësimit) marrin pjese në vlerësim me shkrim + me gojë. Përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier e percaktonë vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	1.Çakalli D., Thomai T., 2005:Frutikultura speciale (Pomaologjia).Tirane 2. Zajmi A., Sylanaj S., Berisha A. 2006: Pemetaria Praktike. Prishtine 3. Zajmi A. 1997 : Pemetaria speciale I. Prishtine. 4.Silbereisen/Gotz/Hartmann.1996;Obstsorten Atlas. Stuttgart. Ulmer
Literatura shtesë:	1. Shtampar F. et al. 2005: Sadjarstvo. Ljublana 2 . Sylanaj S. 2004: Dredheza. Gjakove. 3. Miljković, I. 1996: Opće voćarstvo, Zagreb, 4. Grup autoresh, 1992: Frutticoltura generale, REDA.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Pemëtarisë speciale- Rëndësia, (Klasifikimi pomologjik i pemëve)
Java e dytë:	Pemët farore - Molla: (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika)
Java e tretë:	Nënshartesat dhe kultivarët e mollës
Java e katërt:	Dardha: (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika, nënshartesat dhe kultivarët)
Java e pestë:	Ftoi, Mushmolla, Vadhëza: (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika, nënshartesat dhe kultivarët)
Java e gjashtë:	Pemët bërthamore - kumbulla (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika, nënshartesat dhe kultivarët)
Java e shtatë:	Kollokfium

Java e tetë:	Qershia dhe vishnja (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika, nënshartesat dhe kultivarët)
Java e nëntë:	Pjeshka, nektarina dhe kajsia (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika, nënshartesat dhe kultivarët)
Java e dhjetë:	Pemët imëta (manore) – Dredhëza (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika, kultivarët)
Java e njëmbëdhjetë:	Mjeda dhe Manaferra (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika)
Java e dymbëdhjetë:	Boronica, Rrush serezi (Origjina dhe përhapja, vlera ushqyese, karakteristikat botanike, agropomoteknika,
